



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS
GODIŠNJI IZVEŠTAJ PERFORMANSE
ANNUAL PERFORMANCE REPORT

2019

Prishtinë, Prill 2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

2019

Prishtinë, Prill 2020

Tabela e përmbajtjes

Vizioni, Misioni dhe Vlerat	3
Përmbledhje e fakteve kryesore për vitin 2019	4
Fjalori i shprehjeve	6
Fjala e Auditorit të Përgjithshëm	7
1 Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit	8
1.1 Pavarësia dhe Korniza ligjore	8
1.1.1 Pavarësia institucionale	8
1.1.2 Mandati	9
1.2 Qeverisja e brendshme dhe etika	10
1.2.1 Planifikimi strategjik dhe operativ	10
1.2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ	11
1.2.3 Komunikimi i brendshëm	12
1.3 Mbulueshmëria e auditimit dhe raportimi	12
1.3.1 Fushë veprimi i ZKA-së - llojet e auditimit	12
1.3.2 Auditimet e planifikuara dhe të realizuara	13
1.3.3 Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve	15
1.3.4 Kontrolli i cilësisë	24
1.4 Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse	24
1.4.1 Menaxhimi financiar	25
1.4.2 Shërbimet mbështetëse	28
1.5 Menaxhimi i Burimeve njerëzore	30
1.5.1 Burimet njerëzore	30
1.5.2 Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit	31
1.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit	33
1.6.1 Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin	33
1.6.2 Komunikimi me Mediat, Qytetarët, Organizatat e Shoqërisë Civile, Donatorët dhe akterë të tjerë	35
1.6.3 Bashkëpunimi me ISA-të partnere, marrëveshjet bilaterale, takimet e vizitat	37
1.6.4 Anëtarësimi i ZKA-së në INTOSAI	38
1.6.5 Konferenca e XI-të Vjetore e ZKA-së	39
2 Fokusi i aktiviteteve gjatë vitit 2020	40
3 Llogaridhënia e ZKA-së	41
Shtojca 1: Portofoli i auditimeve për sezonin 2018/19 dhe 2019/20	43
Shtojca 2: Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2019	46


Vizioni, Misioni dhe Vlerat

Vizioni

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve

Vlerat e Zyres Kombëtare e Auditimit (ZKA)

ZKA-ja është e përkushtuar që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe ligjeve relevante, si dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta.



Misioni


Përmes auditimeve cilësore fuqizon llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare

Përmbledhje e fakteve kryesore për vitin 2019

Çështjet kryesore (nga Raporti Vjetor i Auditimit – RVA 2018)

Në RVA 2018 është kërkuar vëmendja e Kuvendit dhe drejtuesve të institucioneve publike, për adresimin e çështjeve, si në vijim:

- planifikimin buxhetor
- cilësinë e raportimit të ndërmarrjet publike
- keqklasifikimet e shpenzimeve
- llogaritë e arkëtueshme
- detyrimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente, si dhe
- regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin e pasurive




ZKA-ja anëtarësohet në INTOSAI


Nga data 1 janar 2020, Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës është pranuar anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)

- ✓ Numri i auditimeve të rregullsisë është rritur për 4 në raport me sezonin e kaluar
- ✓ Auditimet e performancës kanë pasur rritje nga viti 2016. Tani, ato përbëjnë rreth 11 % të auditimeve të ZKA-së
- ✓ Auditimi i Ndërmarrjeve publike (NP) ka filluar në sezonin auditues 2016/17 me 4 NP dhe ka arritur në 14 NP në sezonin 2019/20, 3 më shumë se sezonin e kaluar

Grafiku 1. Portofoli i auditimeve




Grafiku 2. Auditimi i NP-ve



- ✓ Për vitin fiskal 2018 janë dhënë mbi 1,100 rekomandime të auditimit
- ✓ Institucionet e pavarura prijnë për nga numri i rekomandimeve të zbatuara me rreth 65%. Megjithatë, progresi i përgjithshëm nuk është ende i kënaqshëm


Grafiku 3. Rekomandimet e auditimit të rregullsisë për vitin 2018

Rekomandimet e dhëna, sipas institucioneve



Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shkalla e zbatimit të rekomandimeve



Përmbledhje e pasqyrave financiare të ZKA-së, për vitin fiskal 2019

Shpenzimet për Paga e Meditje dhe Mallra e Shërbime mbesin shpenzimet kryesore të ZKA-së. Ndikim në rritjen e përgjithshme të buxhetit për vitin 2019, krahasuar me vitin paraprak, ka pasur ndarja buxhetore në kuadër të shpenzimeve kapitale për zhvillimin e "Softuerit për Menaxhimin e Auditimit"

Grafiku 5. Shpenzimet e ZKA-së për vitin fiskal 2019

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike




Tabela 1. Përmbledhje e pasqyrave financiare të ZKA-së (€ 000)

Tabela 2. Përmbledhje e pasqyrave financiare të ZKA-së

	2019	2018	2017
Burimet e fondeve			
Granti qeveritar	2,895	2,678	2,273
Grantet e përcaktuara të donatorëve	95	18,8	54
Totali i pranimeve	2,990	2,697	2,327
Shfrytëzimi i fondeve			
<i>Operacionet</i>			
Paga dhe Meditje	2,125	2,003	1,757
Mallra dhe Shërbime	710	613	530
Shërbime komunale	33	30	28
	2,868	2,646	2,315
<i>Kapitalet</i>			
Shpenzime kapitale	122	51	12
Totali i pagesave	2,990	2,697	2,327

Fjalori i shprehjeve

AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI (ONISA)	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
OB	Organizata Buxhetore
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
TI	Teknologjia Informative
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm



Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të Performancës dhe Raportin e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2019. Puna jonë është mbështetur në Planin Strategjik 2018-2021, Planin Vjetor të Auditimit 2018/19, që paraprakisht i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe në Planin operativ 2019.

Anëtarësimi me të drejta të plota i Zyrës Kombëtare të Auditimit në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) përbën arritjen më të madhe në historinë e auditimit të jashtëm, të sektorit publik të Republikës së Kosovës. Ky anëtarësim e bën të mundur shkëmbimin e dijes dhe të përvojave me Institucionet Supreme të Auditimit, me 194 shtete anëtare të kësaj organizate, në mënyrë që të zhvillojmë më tutje kapacitetet tona institucionale, për të zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë me integritet të lartë profesional. Tani, mbetet një aspiratë e natyrshme që të angazhohemi për anëtarësimin e ZKA-së në Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).

Edhe gjatë vitit 2019 kemi vazhduar të zgjerojmë portofolin e auditimeve, duke përfshirë më shumë ndërmarrje publike dhe organizata buxhetore nën auditimin e ZKA-së. Në pajtim me Planin Strategjik të ZKA-së kemi vazhduar angazhimin në auditimet e e performancës edhe këtë vit duke e mbajtur numrin e njëjtë, por duke audituar tema dhe sektorë kompleks pasi që edhe në këtë lloj të auditimeve kemi ngritje shumë të mirë të kompetencës profesionale të auditorëve.

ZKA-ja ka shtrirë më tej ndikimin e saj përmes rekomandimeve praktike, për drejtuesit e institucioneve publike të Kosovës. Gëzon fakti që gjatë vitit të kaluar është vërejtur një progres i lehtë në rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit, por ky trend duhet të rritet ndjeshëm për të pasur efekt në menaxhimin e shëndoshë financiar dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike.

Ky vit ka qenë vendimtar për shkak se me ndihmën e BE-së ka filluar zbatimi I Projektit të Binjakëzimit dhe është bërë rishikimi i plotë i të gjithë doracakëve dhe letrave të punës në mënyrë që të bëhet përditësimi i tyre me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikatat e mira ndërkombëtare. Paralelisht jemi në fazën intensive të zhvillimit të softuerit të auditimit përmes së cilit do të shkurtohet koha në auditim, rritet cilësia dhe siguria e auditimeve dhe forcohet transparenca.

Jam i lumtur që kemi mundur të marrin në auditim edhe shumë çështje të rëndësishme të ngritura nga institucionet publike, mediat apo organizatat profesionale, ngase kapacitetet e ZKA-së janë duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme përmes programeve të ndryshme të edukimit dhe përvojat e reja janë duke bërë një ndikim pozitiv në punën audituese. Edhe me këtë rast, dua të nënvizoj përkrahjen e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në veçanti anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa, për trajtimin e raporteve të ZKA-së.

Prishtinë, 30 prill 2020

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

1 Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Raporti i performancës së aktiviteteve të Zyres Kombëtare të Auditimit (ZKA), për vitin 2019 bazohet në strukturën e **Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit**, për të demonstruar nivelin e performancës së ZKA-së kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, ka 25 tregues për të matur performancën e ISA-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare. Këta tregues janë grupuar në gjashtë fusha: 1. Pavarësia dhe Korniza ligjore; 2. Qeverisja e Brendshme dhe Etika; 3. Mbulimi i Auditimit dhe Raportimi; 4. Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet mbështetëse; 5. Burimet njerëzore dhe Trajnimet si dhe 6. Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit.

Së këndejmi, Raporti përfshinë shënime të rëndësishme në lidhje me performancën e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm në përmbushjen e obligimeve të tij kushtetuese e ligjore, në pajtim me SNISA-t.

1.1 Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon **mandatin ligjor** dhe **pavarësinë** e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm (AP)¹. Përveç Kkornizës ligjore të vendit, Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e praktikave të mira ndërkombëtare për këtë fushë janë: Deklarata e Limës (INTOSAI-P 1, ish-SNISA 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (INTOSAI-P 10, ish-SNISA 10). Treguesit që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: *pavarësia* dhe *mandati*.

1.1.1 Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka cilësuar Auditorin e Përgjithshëm si institucion të pavarur dhe më të lartë, të kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të AP-së janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (Ligji i ZKA-së), i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas legjislacionit në fuqi, AP-ja ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

Gjatë vitit 2019, nuk janë shënuar raste të ndonjë ndërhyrjeje nga palët e treta në punën e AP-së. Megjithatë, me Ligjin për Zyrtarët Publikë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 02.02.2019 e që kishte hyrë në fuqi me 11.09.2019, ndërmjet tjerash, ndryshohet edhe statusi juridik i marrëdhënies së punës së auditorëve, respektivisht i stafit auditues të punësuar në ZKA. Si rrjedhim, ky Ligj parasheh që auditorët të kenë rregullim juridik të marrëdhënies së punës si nëpunës civilë - pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës. Ky zhvillim është në kundërshtim me proceset integruuese evropiane të Kosovës sipas agjendës së Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) (neni 97) dhe është hap retroaktiv në të arriturat e deritanishme në fushën e kontrollit financiar - detyrime që Republika e Kosovës i ka ndërmarrë deri tani.

¹ Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Në kundërshtim me rregullimin aktual ligjor që është promovuar edhe nga Bashkimi Evropian në dokumentet zyrtare të tij të ndërlidhura më Kosovën, me Ligjin për Zyrtarët Publikë, ZKA-ja kthehet në situatë para hyrjes në fuqi të ligjit aktual për ZKA-në (qershor 2016). Rrjedhimisht, kjo dëmton statusin e ZKA-së, si një institucion i pavarur i auditimit dhe mund të ketë pasoja për pavarësinë organizative dhe funksionimin e institucionit, si edhe për proceset integruese. Për efektet potenciale negative të këtij ligji, AP-ja i ka njoftuar paraprakisht grupin punues për hartimin e ligjit, Qeverinë dhe deputetët e Kuvendit dhe akterët e tjerë relevant, por përpjekjet nuk kanë qenë të suksesshme. Si rrjedhojë, vlen të përmendet se kushtetutshmëria e këtij ligji është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bazë të kërkesës së parashtruar nga Avokati i Popullit. Deri në një vendim përfundimtar, Gjykata Kushtetuese ka pezulluar zbatimin e këtij ligji.

Për më tepër, edhe Ligji aktual për ZKA-në ka nevojë për amendamentim për sa i përket të drejtës së Qeverisë për të modifikuar kërkesën buxhetore të ZKA-së². Në lidhje me këtë, AP-ja i ka informuar edhe deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike si dhe ata të Komisionit për Buxhet dhe Financa, mirëpo për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, nuk ka mundur të iniciohet procesi i ndryshimit të ligjit. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm i këtij ligji ka të bëjë me heqjen e obligimit për auditime të përvitshme të rregullsisë, për të gjitha organizatat buxhetore (pavarësisht madhësisë, kompleksitetit, rrezikut, etj), cili krijon një barrë të panevojshme për ZKA-në dhe pamundëson aplikimin e qasjes së përzgjedhjes së auditimeve bazuar në rrezik.

1.1.2 Mandati

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së, të përcaktuar në Kornizën ligjore. Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë: mandati i mjaftueshëm dhe i gjerë; qasja në informata; dhe e drejta dhe detyrimi për të raportuar.

Kushtetuta e vendit dhe Ligji i veçantë, i japin AP-së **mandat të gjerë të auditimit** të të gjitha subjekteve të sektorit publik në Kosovë. Megjithatë, disa ligje të veçanta kanë krijuar paqartësi për auditimin e disa institucioneve publike që çështjen e auditimit e kanë trajtuar në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit për AP-në³. Për më tepër, Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk është harmonizuar me Kushtetutën, Ligjin për AP-në dhe Ligjin për Ndërmarrjet publike (NP), lidhur me mandatin e AP-së për auditimin e NP-ve dhe afatet kohore për raportim financiar.

AP-ja, sipas autoritetit kushtetues e ligjor, ka **qasje të pakufizuar** në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi me subjektet e audituara ka qenë korrekt dhe nuk është shënuar ndonjë rast i kufizimit të qasjes për auditorët. Zyrtarëve të autorizuar nga AP-ja u është mundësuar që në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e entiteteve të audituara.

AP-ja e ka autoritetin kushtetues që në mënyrë të pavarur të **raportoje gjetjet** e çdo viti në Kuvend. Meqë, Kuvendi i Kosovës ishte shpërndarë në muajin gusht dhe nuk kishte arritur të konstituohej gjatë vitit 2019, AP-ja nuk ka pasur mundësi që të prezantojë Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2018, para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në seancë plenare.

² Në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare (Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve) për të siguruar pavarësinë e plotë financiare, rekomandohet që buxheti i ISA-ve të trajtohet nga Kuvendi.

³ BQK – Banka Qendrore e Kosovës; AKI – Agjencia Kosovare e Inteligjencës, RTK – Radio Televizioni i Kosovës, FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Ndërmarrja Trepça.

Sikurse edhe gjatë viteve paraprake, ZKA-ja i ka bërë publike të gjitha raportet e auditimit.

1.2 Qeverisja e brendshme dhe etika

Kjo fushë mbulon **qeverisjen e brendshme** dhe **etikën**. Treguesit që ZKA-ja ka aplikuar janë: Planifikimi strategjik dhe operativ; mjedisi i kontrollit organizativ; dhe komunikimi i brendshëm.

1.2.1 Planifikimi strategjik dhe operativ

ZKA-ja zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në Planin Strategjik trevjeçar, Planin Operativ Vjetor dhe Planin Vjetor të Auditimit.

Planifikimi Strategjik

Gjatë vitit 2019, ZKA-ja ka intensifikuar angazhimin për realizimin e **Planit Strategjik 2018-2021**, përkatësisht arritjen e qëllimeve kryesore strategjike, që janë:

1. Përbushja e misionit kushtetues e ligjor, duke kryer auditime relevante në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit;
2. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative;, si dhe
3. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Sipas vetëvlerësimit nga ZKA-ja, përkundër sfidave të natyrave të ndryshme, është bërë një progres i konsiderueshëm në përbushjen e objektivave strategjike të planifikuara me Planin Strategjik, si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Plani Operativ Vjetor

Me këtë plan ishin përfshirë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxheti dhe burimet e financimit, rezultatet, rreziqet, etj., të ndërlidhura me zbatimin e Planit Strategjik e që kanë mbuluar periudhën njëvjeçare kalendarike, 1 janar deri më 31 dhjetor 2019.

Plani Vjetor i Auditimit

Në fillim të sezonit auditues, AP-ja ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2019/20, i cili përfshinë periudhën 1 shtator 2019 deri më 31 gusht 2020 dhe përmban informatat themelore për objektivat vjetore të ZKA-së, procesin e auditimit dhe llojet e tij, Planin Vjetor të Auditimit dhe organizimin, buxhetin dhe burimet njerëzore. Në hartimin e Planit janë marrë në konsideratë përbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë dhe aktualitetin e çështjeve të caktuara dhe adresimi i kërkesave specifike të Kuvendit dhe të palëve të tjera të interesit, si: organizatat e shoqërisë civile, donatorët, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet e burimeve njerëzore dhe financiare që ZKA-ja ka pasur në dispozicion. Ky Plan i është dorëzuar KMFP-së në fillim të sezonit auditues.

1.2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ

Në respektim të kërkesave që burojnë nga SNISA-t⁴, si dhe për të përmbushur pritjet nga ZKA-ja, AP-ja ka bërë përshtatjen e strukturës organizative me qëllim të arritjes së objektivave strategjike të organizatës. Struktura e re është po ashtu në funksion të krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e organizatës menaxhohen në mënyrë efikase dhe ekonomike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Megjithatë, sfidë serioze në këtë fushë paraqet hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrarët Publikë, siç është përmendur në sesionin 1.1.1 .

Kodi i Etikës

Në funksion të afirmimit të vlerave dhe parimeve thelbësore që udhëheqin punën e përditshme të auditorëve, si dhe për të ruajtur dhe shtuar besimin te institucioni, ZKA-ja ka krijuar politika dhe procedura, të cilat kërkojnë që gjithë personeli dhe palët e autorizuara për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike, duke nënshkruar dhe respektuar *Kodin e Etikës* dhe *Deklaratën e pavarësisë profesionale*. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes i ZKA-së është hartuar në frymën e parimeve që përmban Kodi i Etikës i INTOSAI-t. Po ashtu, në ZKA funksionon edhe **Komisioni për Etikë** me mandat që të përcjellë zbatueshmërinë e Kodit të Etikës. Gjatë vitit 2019, ky Komision nuk ka evidentuar ndonjë rast të shkeljes apo mosrespektimit të Kodit.

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Kontrollet e brendshme për aktivitetet joaudituese në ZKA zbatohen përmes rregullave dhe procedurave të vendosura për procese të ndryshme, si: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm. Po ashtu, ZKA-ja ka hartuar edhe dokumentin për menaxhimin e rreziqeve. Menaxhimi i rrezikut në ZKA zbatohet, duke u bazuar në objektivat e vendosura me dokumentet strategjike të ZKA-së dhe kornizën tjetër të aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK). Lidhur me këtë, ZKA-ja ka të dizajnuar një strukturë të mirë të kontrolleve të brendshme. Të gjitha komponentët e kontrolleve operojnë në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve.

Auditori i brendshëm (AB) i ZKA-së ka përgatitur raporte mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme dhe i ka raportuar ato drejtpërdrejtë tek Auditori i Përgjithshëm. Bazuar në Planin Vjetor për vitin 2019, fushat e përcaktuara për rishikim nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kanë qenë: procesi i menaxhimit dhe arkivimit të dosjeve të auditimit, menaxhimi i aktiviteteve të mësimi/trajnimin dhe zhvillimit profesional, procesi i pagesave, menaxhimi i pasurisë jofinanciare në ZKA dhe menaxhimi i prokurimit.

Rishikimi është bazuar në vlerësimin e performancës dhe pajtueshmërisë me rregullat ligjore dhe kornizën e brendshme që rregullon fushat përkatëse. Gjatë vitit 2019, NJAB-i i ka dorëzuar AP-së pesë (5) raporte të auditimit. Auditori i Brendshëm ka ofruar edhe këshilla që kanë të bëjnë me aktivitetet e ZKA-së në lëmin e financave, kontrollit të brendshëm, menaxhimit të rrezikut dhe çështjeve të ndërlidhura me pasurinë.

Komiteti i Auditimit (KA) ka kryer aktivitetet e tij me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes në ZKA. KA-ja i ka shqyrtuar të gjitha raportet e AB-së, përveç atij të Prokurimit për vitin 2019.

⁴Standardi i Qeverisjes 9100, Kontrolli dhe siguri i cilësisë SNISA 140.

1.2.3 Komunikimi i brendshëm

ZKA-ja ka ndërtuar një komunikim efektiv të brendshëm me punonjësit, duke i dhënë mundësi secilit punonjës të shprehet hapur, si në drejtimin vertikal ashtu edhe në atë horizontal për çështjet që lidhen me punën e tyre si dhe për ato në nivel të institucionit. Menaxhmenti i ZKA-së ka mbajtur takime periodike me personelin, sipas nevojave zhvillimore. Vendimet kryesore janë dokumentuar dhe i janë komunikuar stafit.

Dokumentet relevante janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative dhe informacioni shpërndahet tek i tërë stafi, qoftë përmes komunikimit elektronik (e-mail apo rrjeti i brendshëm), apo përmes takimeve, ku punonjësit janë informuar rregullisht mbi çështjet kryesore lidhur me organizatën dhe procesin e auditimit. Puna audituese dokumentohet dhe raportohet përmes organizimit dhe mbajtjes së folderëve publik dhe kjo ka rritur kontrollin e cilësisë së punës sonë.

1.3 Mbulueshmëria e auditimit dhe raportimi

ZKA-ja auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të subjekteve publike për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është aprovuar. ZKA-ja, po ashtu kryen auditime të performancës për të vlerësuar nëse qytetarëve u ofrohen shërbimet që kanë nevojë, me kosto efektive.

Treguesit e kësaj fushe ndërlidhen kryesisht me: *fushëveprimin/mbulueshmërinë e auditimeve; raportimin e rezultateve të auditimeve dhe adresimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara.*

1.3.1 Fushë veprimi i ZKA-së - llojet e auditimit

Në përputhje me mandatin e saj ligjor, ZKA-ja kryen kryesisht këto lloje të auditimeve⁵:

1. Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)	<ul style="list-style-type: none">○ Të organizatave buxhetore (ministrive, institucioneve të pavarura dhe komunave), bazuar në sistemin e parësë së gatshme○ Të ndërmarrjeve publike, bazuar në sistemin aktual○ Të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare
2. Auditime të performancës	<ul style="list-style-type: none">○ Të angazhimeve qeveritare, sistemeve, operacioneve, programeve, aktiviteteve ose organizatave○ Të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare
3. Auditime të teknologjisë informative (TI)	<ul style="list-style-type: none">○ Të sistemeve të teknologjisë informative (TI) dhe kontrolleve të ndërlidhura me to

⁵ Auditimet e TI-së, ZKA-ja i ka zhvilluar kryesisht në kuadër të auditimeve të performancës. Përgjithësisht ISA-të kryejnë auditimin e TI-së njëkohësisht me auditimin e pasqyrave financiare, rishikimin e kontrolleve të brendshme ose si auditim performancë të sistemeve të TI-së ose të aplikimeve të TI-së. Auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare (për të vlerësuar saktësinë e pasqyrave financiare të subjektit); në auditimet e pajtueshmërisë (vlerësimi i kontrolleve të brendshme); në auditimet e performancës (përfshirë çështjet e sistemeve të informacionit), etj.

Auditimet e rregullsisë në subjektet individuale kryhen për çdo vit, duke filluar në shtator, ndërsa përfundojnë me raportet e auditimit, të cilat publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve të rregullsisë përmbyllet në fund të muajit gusht, kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Fushat, objektivat, koha e auditimit dhe e raportimit të **auditimeve të performancës** përcaktohen në Planin Vjetor të Auditimit, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, kapacitetet ekzistuese, si dhe kriteret e tjera përkatëse.

Në bazë të marrëveshjes me donatorët apo përfituesit e tyre, ZKA-ja kryen auditime të financiare apo të performancës së projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Auditimi i projekteve që financohen nga Banka Botërore, qeveritë e vendeve të ndryshme, etj është edhe një tregues për besueshmërinë dhe cilësinë e punës audituese të ZKA-së.

1.3.2 Auditimet e planifikuara dhe të realizuara

Deri në fund të vitit 2019, ZKA-ja ka përfunduar dhe publikuar **128 raporte**, si në vijim:

115 Raporte të auditimit të rregullsisë

- ✓ Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2018
- ✓ 94 raporte për organizatat buxhetore
- ✓ 11 raporte të auditimit të Ndërmarrjeve Publike, dhe
- ✓ 9 raporte të auditimit të projekteve (të financuara nga donatorët).

13 raporte të auditimit të performancës

- ✓ 13 raporte të auditimit të performancës (prokurim dheprojekte).

Ndërsa, me Planin Vjetor për sezonin e auditimit 2019/20, ZKA-ja planifikon⁶ të kryejë auditimet, si në vijim:

119 Auditime të rregullsisë

- ✓ Auditimin e Raportit Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2019
- ✓ 95 organizata buxhetore (27 institucione të nivelit qendror, 30 institucione të pavarura dhe 38 të nivelit lokal)
- ✓ 14 Ndërmarrje Publike, dhe
- ✓ 9 auditime të projekteve (të financuara nga donatorët).

13 Auditime të performancës

- ✓ 13 auditime të performancës (për fusha të ndryshme).

Për dallim nga sezoni i kaluar, në portofolin e auditimeve të rregullsisë është shtuar Fondi i Sigurimeve Shëndetësore si një organizatë e re buxhetore. Ndërsa, për auditimin e 22 institucioneve të pavarura, ZKA-ja ka angazhuar një kompani private të auditimit, e cila do të përkrahë procesin gjatë punës në terren megjithatë, sigurimi i cilësisë së raporteve dhe dhënia

⁶Për shkak të ndikimit të pandemisë COVID 19 në funksionimin normal të institucioneve publike në Kosovë, ZKA-ja do të sfidohet në realizimin e planit të auditimit.

e opinionit të auditimit do të bëhet nga AP-ja. Po ashtu, në vitin 2019 është rritur edhe për tre (3) numri i auditimeve të Ndërmarrjeve Publike, për dallim nga vitit i kaluar. Ato janë: KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni dhe Ndërmarrja e re Energjetike e Kosovës.

Tabela 2 tregon portofolin e përgjithshëm të auditimeve, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për pesë (5) sezonet/vitet e fundit të auditimit. Evidenca e raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces është paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Raporti.

Tabela 2. Portofoli i përgjithshëm i auditimeve gjatë katër sezoneve/viteve të fundit					
Llojet e auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit
	2015/16	2016/2017	2017/2018	2018/2019	2019/2020
Auditime të rregullsisë	93	99	109	115	119
- Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës	1	1	1	1	1
- Institucione qendrore	24	24	24	26	27
- Institucione të pavarura	30	30	30	30	30
- Komuna	38	38	38	38	38
- Ndërmarrje Publike	0	4	9	11 ⁷	14
- Projekte	0	2	7	9	9
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020⁸
Auditime të performancës	5	11	13	13	13
- Performancë dhe Prokurim	5	9	10	11	10
- Teknologji Informative	-	2	3	0	3
- Projekte	-	-	-	2	-
Gjithsej	98	110	122	128	132


Siç është prezantuar në Tabelën 2 dhe Grafikon 6, numri i auditimeve të rregullsisë është rritur gradualisht nga sezoni i auditimit 2015/16. Kjo rritje i atribuohet kryesisht zgjerimit të portofolit të auditimeve të Ndërmarrjeve Publike, rritjes së numrit të organizatave buxhetore dhe të projekteve. Po ashtu, numri i auditimeve të performancës është rritur nga viti 2016, ndërsa dy vjetët e fundit numri i tyre është 13, aq sa janë planifikuar edhe për vitin 2020, siç mund të shihet edhe në Grafikon 7, më poshtë. Ndonëse me Planin Strategjik të ZKA-së është paraparë

⁷ Ndërmarrja Lotaria e Kosovës, ishte mbyllur me ligj, gjatë kohës që ishte në auditim.


⁸ Për shkak të shtrirjes së pandemisë COVID 19, edhe në vendin tonë, nuk do të mund të realizohet rritja e numrit të auditimeve, siç është planifikuar me Planin Strategjik të ZKA-së.

që numri i auditimeve të performancës të rritet për çdo vit me nga dy auditime, kjo objektivë nuk ka mundur të arrihet pasi që gjatë vitit 2019, të gjithë auditorët e performancës kanë ndjekur programin njëvjeçar për edukim profesional, të realizuar nga ZKA-ja me përkrahjen e Zyres Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Përveç kësaj, realizimi i disa auditimeve ka marrë shumë kohë, qoftë për shkak të vonësive në ofrimin e përgjigjeve e komenteve nga menaxhmenti i entiteteve të audituara, apo edhe për arsye të kujdesit të shtuar në kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së auditimeve, meqë disa prej temave kanë qenë më komplekse për nga natyra dhe kanë kërkuar ekspertizë të jashtme.

Grafiku 6. Trendi i auditimeve të rregullsisë



Grafiku 7. Trendi i auditimeve të performancës



1.3.3 Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve

Auditimet e rregullsisë

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2018 ishte dorëzuar në Kuvendin e Kosovës brenda afatit ligjor. Megjithatë, ai nuk është prezantuar nga AP-ja në seancë plenare, për shkak të moskonstituimit të Kuvendit.

Çështjet kryesore të RVA-së nënvizojnë nevojën për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të lartë të entiteteve të audituara për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat, si në vijim: planifikimin buxhetor, cilësinë e raportimit tek Ndërmarrjet Publike, keqklasifikimet e shpenzimeve, mosefikasitetin në shpenzimin e fondeve nga borxhet publike, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, detyrimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente, si dhe regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin joadekuat të pasurive.

Në RVA janë pasqyruar edhe çështje që ndërlidhen me pajtueshmërinë me kuadrin ligjor, si: dobësitë në prokurim, menaxhimin e projekteve, rekrutimeve, etj., për të cilat janë dhënë rekomandime konkrete.

Ndonëse nuk janë bërë vlerësime individuale për të kuptuar më saktë ndikimin e rekomandimeve të auditimit për subjektet e audituara, konkludimi i përgjithshëm është se ndikimi i punës së ZKA-së mund të vërehet në fushat si në vijim: përmirësimi i raportimit financiar zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta; përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit; rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike (të gjitha raportet e auditimit janë publikuar dhe pothuaj të gjitha raportet e performancës janë prezantuar para publikut dhe palëve të interesit), etj.

Në raportet e auditimit të kryera gjatë vitit 2019 e që lidhen me Pasqyrat Financiare për vitin 2018, është raportuar për gjendjen e rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve nga organizatat buxhetore dhe NP-të për vitet 2016, 2017 dhe 2018 janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme, 3, 4 dhe 5.

Tabela 3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2018 (për v. 2017), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara		Të mbyllura ⁹	
	Nr	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	357	144	40	59	17	103	29	51	14
Institucionet e pavarura	164	106	65	19	12	22	13	17	10
Komunat	600	188	31	123	21	229	38	60	10
Totali	1,121	438	39	201	18	354	32	128	11

Tabela 4. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2017 (për v. 2016), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa adresuara	
	Nr	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	307	112	36	57	19	138	45
Institucionet e pavarura	220	118	54	63	29	39	17
Komunat	650	165	25	191	29	294	45
Totali	1,177	395	34	311	26	471	40

Tabela 5. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2016 (për v. 2015), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara	
	Nr	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	338	93	28	126	37	119	35
Institucionet e pavarura	184	52	28	70	38	62	34
Komunat	640	153	24	229	36	258	40
Totali	1,162	298	26	425	36	439	38

Auditimi për vitin 2018 ka rezultuar me gjithsej 1,121 rekomandime. Nga auditimet e kryera është konstatuar një përmirësim i nivelit të adresimit të rekomandimeve nga të gjitha grupet e entiteteve të audituara. Në përgjithësi, shkalla e zbatueshmërisë së rekomandimeve të

⁹ Rekomandime të mbyllura janë konsideruar rekomandimet të cilat nuk mund të zbatohen ose për shkak se ato kanë të bëjnë më ngjarje të kaluara apo për shkak se rekomandimi nuk është në përputhje me rrethanat e reja të krijuara.

auditimit është përmirësuar në krahasim me vitin 2017 (nga 34% në 39%), edhe pse në këtë “përmirësim” ka ndikuar edhe cilësimi i një pjese të rekomandimeve si të mbyllura.

Sa i përket Ndërmarrjeve Publike, nga nëntë (9)¹⁰NP-të e audituara për vitin fiskal 2017, ZKA-ja në vitin vijues ka vazhduar auditimin e tetë (8) prej tyre dhe rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve për këto tetë (8) NP janë paraqitur në Tabelën 6, më poshtë.

Tabela 6. Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga NP-të e audituara në vitin fiskal 2017

Ndërmarrja Publike e audituar	Rekomandimet e dhëna		Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Hekurudhat e Kosovës –Trainkos	13		8	62	2	15	3	23
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK)	11		7	64	1	9	3	27
KRU Prishtina	20		10	50	3	15	7	35
KRM Uniteti	15		0	0	2	13	13	87
KRU Hidroregjioni Jugor	13		7	54	2	15	4	31
Stacioni i Autobusëve	18		7	39	2	11	9 ¹¹	50
Hortikultura	19		13	68	3	16	3	16
KRU Drini i Bardhë	20		9	45	4	20	7	35
Totali	129		61	47	19	15	49	38

Gjithashtu, ZKA-ja ka vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të RVA-së të dhëna për Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe për kuvendet komunale. Nga gjithsej 35 rekomandime¹² të dhëna, 5 janë zbatuar plotësisht, 17 ishin në proces të zbatimit dhe 13 të tjera nuk ishin adresuar ende. Për 6 rekomandimet e dhëna në auditimet e performancës, mbetet të bëhet auditimi përcjellës i zbatimit të tyre, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i saktë i progresit. Për rekomandimet e dhëna në RVA për vitin 2018, Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave ka përgatitur planin e veprimit, ndërsa ZKA-ja do të vlerësojë progresin e tyre në RVA për vitin 2019.

¹⁰ Përveç auditimeve të paraqitura në Tabelën 6, ZKA-ja ka audituar edhe NP ‘Aeroporti i Gjakovës’ për vitin fiskal 2017, mirëpo mungojnë statistikat e zbatimit të rekomandimeve, sepse kjo NP nuk është audituar nga ZKA-ja në vitin 2018.

¹¹ Dy prej këtyre rekomandimeve janë të pazbatuara, por të mbyllura.

¹² Prej këtyre rekomandimeve, 5 janë dhënë për Kuvendin e Kosovës, 29 për Qeverinë dhe 1 për Kuvendet komunale. Nga këto rekomandime, 6 janë dhënë në lidhje me auditimin e performancës.

Auditimet e performancës

Raportet e auditimit të performancës, të publikuara gjatë vitit 2019 kanë mbuluar fusha të rëndësishme me interes për qytetarët, Kuvendin dhe palët e tjera të interesit. Zhvillimi ekonomik, mirëqenia sociale, mjedisi, arsimi dhe shëndetësia, siguria dhe menaxhimi i parasë publike përmes prokurimit publik kanë qenë në fokus të auditimit për vitin 2019. Përmes këtyre auditimeve, ZKA-ja ka synuar të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

Tabela 7. Temat e auditimeve të performancës sipas fushave

Nr. Audit	Fusha	Tema
5	ZHVILLIMI EKONOMIK DHE MIREQENIA SOCIALE	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018 – 2020 në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës
		Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit
		Zhvillimi i kapaciteteve në procesin e bërjes së politikave dhe koordinimit të projektit
		Tregues të performancës për nivelin lokal qeverisës 2018
		Procesi i menaxhimit të granteve, subvencioneve në sektorin e bujqësisë
1	SHËNDETËSIA	Siguria e Ushqimit - Rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit
1	ARSIMI	Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore
2	MJEDISI DHE SIGURIA	Siguria në Trafikun Rrugor
		Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës
4	PROKURIMI PUBLIK	Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit
		Ndarja e tenderëve në lloje
		Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë
		Projektet e financuara nga grantet e DEMOS për vitin 2018

Gjatë vitit 2019 janë publikuar 13 raporte të auditimit të performancës. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 179 rekomandime për të adresuar gjetjet e konstatuara dhe për të përmirësuar proceset dhe mangësitë me të cilat janë duke u ballafaquar në sistemet aktuale.

Në vijim janë paraqitur shkurtimisht fokusi dhe përfundimet kryesore të këtyre raporteve.

“Procesi i menaxhimit të granteve, subvencioneve në sektorin e bujqësisë”

Fokusi i këtij auditimi ishte vlerësimi i politikave strategjike dhe programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, këshillimi dhe monitorimi i tyre nga institucionet përgjegjëse. Po ashtu është vlerësuar edhe procesi i dhënies së granteve dhe subvencioneve, duke përfshirë kontrollet në terren. Ky auditim është kryer si përgjigje ndaj kërkesës nga Kuvendi i Kosovës dhe duke pasur parasysh rëndësinë që sektori i bujqësisë ka në zhvillimin ekonomik të vendit.

Auditimi ka nxjerrë në pah se përkundër hartimit të strategjisë dhe programeve për bujqësi, si dhe rritjes së vazhdueshme të financimit nga buxheti i shtetit, ka mangësi të theksuara të cilat rrezikojnë efektivitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë. Mënyra aktuale e monitorimit të programeve nuk siguron matjen e rezultateve dhe qëndrueshmëri në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Ministria) ka miratuar dy programe të veçanta të mbështetjes financiare pa analizë paraprake, e cila nuk siguron rezultate të qëndrueshme dhe shfrytëzim efektiv të mjeteve.

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 është bazuar në parimet e Instrumentit për Asistencë në Para-Anëtarësim për Zhvillim Rural (IPARD), mirëpo ende nuk janë themeluar strukturat sipas rregullave të IPARD-it dhe për dallim nga vendet e rajonit, Kosova nuk ka përfituar fonde nga BE-ja për të financuar zbatimin e masave dhe programeve të parapara për sektorin e bujqësisë. Mekanizmat e vendosur nga Ministria nuk kanë arritur të menaxhojnë si duhet procesin e dhënies së granteve dhe subvencioneve, i cili është përcjellë me vonesa deri në tetë muaj. Po ashtu, edhe koordinimi ndërmjet Ministrisë dhe komunave rreth mbështetjes së sektorit të bujqësisë nuk është i mirë, pasi ka raste që fermerët për qëllime të njëjta kanë

përfituar, edhe nga Ministria, edhe nga komuna.

“Zhvillimi i kapaciteteve në procesin e bërjes së politikave dhe koordinimit”

Fokusi i këtij auditimi ishte të vlerësohet nëse projekti kishte arritur qëllimet e synuara në zhvillimin e kapaciteteve në procesin e bërjes së politikave dhe koordinimit, d.m.th efektiviteti dhe efikasiteti i mbështetjes së ofruar. Qëllimi i auditimit ishte të vlerësohet performanca e Projektit dhe të inkurajohet orientimi drejt rezultateve dhe shtimit të vlerës për periudhën e mbetur. Ky Raport është realizuar në bazë të marrëveshjes ndërmjet ZKA-së dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar - Sida.

Auditimi ka nxjerrë përfundimin se projekti në përgjithësi ka arritur rezultate të rëndësishme, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e politikave brenda Qeverisë, duke futur mekanizma për kryerjen e analizave të politikave, analizën e ndikimit dhe mekanizmat mbështetës, për përfshirjen efektive të shoqërisë civile. Pavarësisht kësaj, ekziston rreziku që pas përfundimit të Projektit, Qeveria nuk do të ketë në dispozicion kapacitete të mjaftueshme për të kryer analizat e nevojshme të ndikimit ekonomik, Planifikimit Strategjik dhe komponenteve të tjera të procesit për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit.

Raporti thekson se mungesa e një procesi të rregullt të komunikimit interaktiv nga ekspertët afatgjatë të Projektit me të gjithë përfituesit e synuar – ministritë e linjës dhe departamentet e Zyrës së Kryeministrit mund të krijojë vështirësi në identifikimin e qartë të nevojave të tyre zhvillimore dhe plotësimin e këtyre mangësive. Kjo mund të reflektojë me humbjen e mundësisë për përfitim nga ndihma e ekspertëve të SIDA-s.

“Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësllësit”

Fokusi i këtij auditimi ishte që të vlerësohet nëse procesi për përcaktimin e tarifave është dizajnuar dhe funksionon mirë dhe se të gjitha tarifat përcaktohen në mënyrë transparente, saktë dhe drejt.

Auditimi ka konstatuar që edhe përkundër progresit të arritur nga rregullatorët në procesin e përcaktimit të tarifave, ka disa mangësi që ndikojnë në saktësinë e tarifave të aprovuara dhe të cilat rrezikojnë që tarifat të mos jenë drejt të përcaktuara. Gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, rregullatorët nuk kanë arritur të sigurojnë transparencë të mjaftueshme, si dhe vendosje plotësisht të drejtë dhe të saktë të tarifave. Raporti thekson se Rregullatorët dhe ofruesit e shërbimeve publike nuk kanë zhvilluar një proces të identifikimit të sasisë së konsumuar të shërbimeve nga konsumatorët, të cilët janë të liruar nga pagesa e shërbimeve publike për t'u kompensuar nga autoritetet përkatëse. Përcaktimi i kostove operative, kostove kapitale dhe koeficienteve tjerë të rëndësishëm financiar nuk aprovohet plotësisht bazuar në analiza përkatëse dhe të dokumentuara me sqarime të mjaftueshme dhe të qarta. Prandaj, përcaktimi i tarifave për shërbimet publike nuk është bërë në plotësi sipas kriterëve të matshme dhe në përshtatje me shpenzimet reale dhe relevante.

“Siguria në Trafikun Rrugor”

Fokusi kryesor i këtij auditimi ishte të vlerësohet nëse institucionet publike kanë ndërmarrë veprimet e duhura për të ofruar dhe promovuar siguri në trafikun rrugor në vend.

Raporti ka konkluduar se mungesa e zbatimit, organizimit dhe koordinimit të aktiviteteve nga autoritetet përgjegjëse e bënë të pasigurt trafikun rrugor për pjesëmarrësit në trafik. Policia e Kosovës, e cila duhet të garantojë zbatimin e rregullave nga pjesëmarrësit në trafik dhe

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT) së bashku me komunat, të cilat duhet të ofrojnë siguri në rrugë dhe infrastrukturë për pjesëmarrësit në trafik, nuk janë treguar efektivë dhe nuk po bëjnë sa duhet për të rritur sigurinë në trafik.

Mbulimi i rrugëve me kontrole policore në trafikun rrugor në rajonin e Prishtinës nuk është i mjaftueshëm. Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës karakterizohet me të dhëna jo të plota dhe të sakta sa i përket analizimit dhe identifikimit të shkaktarëve dhe faktorëve të aksidenteve në trafikun rrugor. MIT-ja nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për identifikimin dhe menaxhimin e vendeve të rrezikshme në rrugë (pikave të zeza) si dhe nuk ka arritur të funksionalizojë Këshillin për Sigurinë në Trafikun Rrugor deri në fund të vitit 2018. Monitorimi ndaj qendrave për kontrole teknike të automjeteve nga MIT-ja dhe subjekti i autorizuar për mbikëqyrje ishte i mangët. Po ashtu, edhe Komuna e Prishtinës nuk ka arritur që të sigurojë mirëmbajtje të duhur dhe permanente për të gjitha rrugët për të cilat është përgjegjëse, përfshirë edhe sinjalizimin.

“Siguria e Ushqimit - Rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit”

Fokusi i këtij auditimi ishte që të vlerësohet nëse Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka vendosur sistem adekuat për të ofruar siguri në ushqim.

Auditimi ka nxjerrë në pah se AUV-i ende nuk e ka plotësisht funksional sistemin e sigurisë në tërë zinxhirin ushqimor dhe për pasojë nuk ka siguri se ushqimi në treg është mjaftueshëm i kontrolluar dhe është i sigurt për konsumatorin. Procedurat e vendosura nuk mbulojnë tërë procesin e sigurisë ushqimore. Edhe ato procedura që ekzistojnë, nuk janë zbatuar mjaftueshëm për të dhënë siguri se ushqimi në treg kontrollohet mjaftueshëm dhe ka siguri për konsumatorin. Mangësitë janë vërejtur edhe në procesin e planifikimit të kontrolleve dhe mungesën e analizës së rreziqeve.

Më tutje, vlerësimi i sigurisë në ushqim përmes listave të kontrollit nuk i përfshinë të gjitha parimet e Analizës së Rrezikut dhe Pikave të Kontrollit Kritik (HACCP), të cilat janë kërkesa që dalin edhe nga Ligji i Ushqimit. Po ashtu, inspektorët komunal nuk janë transferuar në Agjencinë Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe nuk ka koordinim të mirë të kontrolleve mes nivelit qendror dhe atij lokal. Kjo rritë mundësinë e kontrolleve joefikase, sikurse në rastin e tregjeve të kafshëve dhe produkteve me prejardhje bimore që nuk kontrollohen nga asnjëri nivel.

“Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës”

Ky auditim është **fokusuar** në procesin e kontrollit të cilësisë së derivateve të naftës që nga momenti i hyrjes së këtyre produkteve në pika doganore e deri te qarkullimi i tyre në treg të brendshëm, si dhe procesin e monitorimit të këtyre kontrolleve nga palët përgjegjëse.

Auditimi ka nxjerr në pah se kontrolli dhe monitorimi i derivateve të naftës, që në import menaxhohet nga Dogana e Kosovës dhe në tregun e brendshëm nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është përcjellë me mangësi të shumta. Në pjesën e importit, cilësia e derivateve të naftës nuk është arritur të sigurohet si rezultat i lejimit të importimit të derivateve të naftës, duke u bazuar në testim të një numri të vogël të parametrave në sistem, i cili jo gjithmonë ka evidentuar trupat që kanë bërë marrjen e mostrave dhe me raste kur trupat nuk kanë mundur të identifikohen, si dhe në mungesë të akreditimit të laboratorit. Cilësia e derivateve të naftës në tregun e brendshëm po ashtu nuk ka arritur të sigurohet, për shkak të testimit të një numri të vogël të parametrave, mungesës së monitorimit adekuat të procesit të akreditimit, si dhe shkeljeve të kërkesave të autorizimit nga Laboratorët dhe funksionimit pa autorizim të Trupave Inspektuese.

Mangësitë e identifikuara, e vënë në pikëpyetje kompetencën dhe besueshmërinë e marrjes së mostrave dhe testimit të tyre, si dhe bëjnë që sistemi të mos jetë në gjendje të sigurojë cilësi të derivateve të naftës për qytetarët e Kosovës.

Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore”

Fokusi i këtij auditimi ishte që të vlerësohet nëse institucionet publike arsimore dhe palët përgjegjëse kanë siguruar kushte dhe mirëmbajtje të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor në objektet e shkollave të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët.

Auditimi ka konstatuar se institucionet publike nuk kanë siguruar mirëmbajtje në nivel të duhur në institucionet arsimore dhe për pasojë nuk ofrojnë kushtet elementare për zhvillimin e procesit mësimor. Nuk ka mirëmbajtje të vazhdueshme për të mundësuar zhvillimin e mësimin në një ambient të shëndetshëm dhe me kushte themelore mësimore. Nga 18 objektet shkollore që janë vlerësuar, vetëm shtatë (7) prej tyre janë në nivel të pranueshëm për zhvillimin e aktiviteteve mësimore. Përderisa, në objektet tjera shkollore mangësi të theksuara kishte në furnizimin me materiale dhe pajisje higjienike, gëlqerosjen vjetore të mureve dhe dezinfektimin e tyre, gjendjen e inventarit shkollor, nyjeve sanitare, ajrosjen e objektit dhe ventilimin e tualeteve.

Raporti thekson se institucionet qendrore dhe lokale nuk kanë arritur të koordinojnë, mbikëqyrin dhe delegojnë detyrat rreth inspektimeve që duhen kryer në nivele të ndryshme dhe nuk kanë hartuar infrastrukturë të plotë ligjore.

“Ndarja e tenderëve në llote”

Fokusi i këtij auditimi ishte për të vlerësuar nëse ndarja e tenderëve në llote është bërë në mënyrë efektive për të inkurajuar pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe

të mesme, për të rritur konkurrencën, si dhe për të arritur vlerën për para.

Auditimi ka nxjerrë në pah se katër komuna të audituara nuk i kishin arritur objektivat që synon Ligji për Prokurim Publik nga ndarja e tenderëve në pjesë e që është promovimi i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe rritja e konkurrencës. Komunitat nuk kishin siguruar informata rreth kapaciteteve financiare dhe teknike të furnizuesve potencial për t'i kategorizuar si duhet. Prandaj, nuk dihet nëse ndarja e tenderëve në lloje kishte nxitur apo jo zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ndarja e tenderëve në lloje nuk kishte rezultuar as me rritje të konkurrencës, andaj komunitat nuk kishin arritur ndonjë përfitim në kuptim të çmimeve më të ulëta, të cilat priten për shkak të rritjes së konkurrencës. Efikasiteti në zbatimin e kontratave ishte arritur vetëm pjesërisht dhe për pasojë disa projekte nuk ishin përfunduar as pas tri vjetëve pas fillimit të punëve, për shkak se nuk ishin siguruar fondet e nevojshme në kohën e duhur.

“Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë”

Fokusi i këtij auditimi ishte për të vlerësuar nëse Autoritet Kontraktuese e kanë arsyetuar dhe dokumentuar mjaftueshëm përdorimin e kësaj procedure, si dhe nëse kanë arritur çmime më ekonomike.

Auditimi ka nxjerrë në pah se institucionet publike të audituara nuk kishin arsyetuar mjaftueshëm përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe nuk i kishin shteruar të gjitha mundësitë për të shmangur përdorimin e kësaj procedure. Ato nuk kishin konsideruar hartimin e një liste të furnizuesve potencial, e cila do të përdorej në aktivitetet e prokurimit me procedurë të negociuar, sidomos në rastet kur faktorë të jashtëm imponojnë prokurime urgjente dhe nuk kishin shqyrtuar alternativat në treg si zëvendësim për produktet/shërbimet, për

të cilat kishin nevojë. Përveç këtyre, asnjëri entitet i audituar nuk kishte bërë analiza të përfitimeve dhe kostove pas zbatimit të kontratave. Si pasojë e mos hulumtimit të tregut dhe mungesës së analizës së kontratave paraprake, entitetet e audituara nuk kishin siguruar konkurrencë dhe çmime ekonomike.

“Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit”

Fokusi i këtij auditimi ishte të vlerësohet nëse organizatat buxhetore menaxhojnë në mënyrë të duhur kontratat publike të ndërtimit. Po ashtu, është vlerësuar nëse është kryer monitorimi i duhur i performancës së kontratës, për t'u siguruar që projektet e ndërtimit përfundohen në kohë me çmimin e kontraktuar dhe sipas specifikacioneve teknike, në mënyrë që të arrihet synimi i përcaktuar.

Raporti ka theksuar se kontratat publike të ndërtimit nuk ishin menaxhuar në mënyrë efektive dhe efektive nga organizatat buxhetore. Auditimi ka evidentuar dobësi thelbësore në procesin e menaxhimit të kontratave publike të ndërtimit në të gjitha fazat. Entitetet e audituara nuk kishin kryer vizita në terren për të verifikuar përshtatshmërinë e lokacionit, bashkëpunimi në mes palëve të përfshira në memorandumet e mirëkuptimit nuk ishte në nivelin e duhur dhe mjetet ligjore që ndihmojnë në realizimin e kontratave nuk kishin efektin e duhur. Për më tepër, dështimi i marrjes së lejeve të ndërtimit dhe aplikimi i duhur i të gjitha dokumenteve të nevojshme për ndërtim ka rezultuar që projektet të pësojnë vonesa në realizim, duke filluar nga 2 deri në 22 muaj.

“Projektet e financuara nga grantet e DEMOS-it për vitin 2018”

Fokusi i këtij auditimi ishte të vlerësojë nëse procedurat e prokurimit në projektet e audituara ishin kryer në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe nëse investimet janë realizuar dhe funksionalizuar me kohë për

përdorim nga qytetarët. Ky Raport është realizuar në bazë të marrëveshjes në mes ZKA-së dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Auditimi ka nxjerrë në pah se të gjitha projektet e audituara në të cilat është investuar nga granti i performancës janë shpenzuar për qëllimet e grantit. Po ashtu, projektet nuk kanë arritur të funksionalizohen dhe të lëshohen në përdorim për qytetarët brenda kohës së dakorduar me donatorin. Pavarësisht kësaj, auditimi ka identifikuar disa dobësi siç janë: vonesa në dërgimin e mallit, mungesa e vëmendjes në mbikëqyrjen e projekteve nga menaxherët e kontratave, si dhe mospërdorimi i duhur i fjalorit të përbashkët të prokurimit gjatë vlerësimit të tenderëve. Më tutje edhe pse komunat e audituara kishin mbajtur dëgjime publike me qytetarët dhe projektet e investuara ishin qoftë në strategjitë për investime apo në planet e punës, ato nuk kanë vendosur një proces standard të pranimit të kërkesave, shqyrtimit të tyre dhe përcaktimit të prioritetëve për investimet në projektet përkatëse. Siqoqoftë, të gjitha projektet ishin përfunduar dhe u është ofrrar qasje të gjithë qytetarëve pa dallim.

“Tregues të performancës për nivelin lokal qeverisës 2018”

Analiza e bërë në këtë Raport paraqet krahasimin e dy kriterëve themelore si dhe nëntë treguesve të tjerë. Kriteret kanë të bëjnë me opinionin e auditimit, dhënë në raportet individuale financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018.

Kjo analizë ka nxjerrë në pah se në nivel të përgjithshëm, ekziston një shkallë mbi 70% e ekzekutimit të projekteve kapitale, por shikuar individualisht, disa komuna na paraqiten me një performancë të dobët në këtë drejtim. Madje, kjo është e pranishme në disa raste edhe kur një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të investimeve kapitale planifikohet të mbulohet nga granti qeveritar. Kjo vë në pah një pakujdesi të menaxhmentit në planifikimin

dhe zbatimin e projekteve kapitale. Shumica e komunave kanë një tendencë të shfrytëzimit të kontratave për marrëveshje të veçanta në mospërputhje me qëllimin e tyre. Madje, disa komuna të vogla angazhojnë numër të konsiderueshëm të këtyre punonjësve.

Nën arsyetimin e mungesës së kapaciteteve, shumica e komunave nuk kryejnë verifikimin e pronave të tatimpaguesve. Kjo ndikon në faturimin jo sipas gjendjes reale në terren.

“Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018 – 2020 në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës”

Fokusi i këtij auditimi ishte që të vlerësohet nëse procesi i përgatitjes dhe zbatimit të dokumentit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) ka adresuar objektivat strategjike të përcaktuara, për planifikim të mirëfilltë dhe financim të politikave prioritare në vend.

Raporti i auditimit ka theksuar se KASH-i nuk trajtohet mjaftueshëm për të siguruar planifikime buxhetore në përputhje me prioritetet strategjike në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës. Auditimi vë në pah se planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i realizimit të objektivave strategjike nuk është në nivelin e duhur. Kjo ka bërë që të zbehet rëndësia dhe qëllimi që ka KASH-i në planifikimin afatgjatë të objektivave dhe buxhetit. Ministria e Financave (MF) bënë finalizimin e buxhetit në KASH, duke u bazuar në projeksionet makroekonomike dhe projeksionet e buxhetit vjetor paraprak për vitet e ardhshme, por jo duke u bazuar edhe në analiza të mirëfillta të kërkesave nga organizatat buxhetore.

MF-ja ka bërë aprovimin e projekteve të caktuara, të cilat nuk janë objektiva strategjike të nivelit qendror. Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nuk kanë arritur të bëjnë planifikim të duhur financiar të projekteve/aktiviteteve dhe realizim të buxhetit për projekte të caktuara

duke rrezikuar realizimin e objektivave prioritare strategjike të qeverisë. Për

rjedhje, KASH-i nuk është plotësisht në funksion të një planifikimi të qëndrueshëm.

1.3.4 Kontrolli i cilësisë

Cilësia e auditimeve dhe përmirësimi i tyre është synim i vazhdueshëm, jo vetëm në zbatimin e standardeve dhe kërkesave në fushën audituese, por që auditimet e realizuara t'i ofrojnë publikut dhe Kuvendit në kohën e duhur informatat e besueshme mbi administrimin dhe përdorimin e fondeve dhe pasurisë publike.

ZKA-ja ka të themeluar Departamentin për Metodologji dhe Sigurimin e Cilësisë, me qëllim të ngritjes së cilësisë së auditimeve në një nivel sa më të lartë. Ky departament, i cili vepron në pajtim me SNISA-t 140 (Kontrolli i cilësisë), kryen rishikimin e auditimeve të realizuara, duke u siguruar se gjatë kryerjes së punës ekipet e auditimit kanë zbatuar plotësisht SNISA-t, si dhe Doracakun e Auditimeve, të aprovuar nga AP-ja. Përzgjedhja e auditimeve për rishikim nga ky departament, bëhet duke pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin e auditimeve, si dhe duke konsideruar mbulueshmërinë e të gjitha ekipeve të auditimit në procesin e rishikimit të dosjeve të auditimit.

Për sezonin 2018/2019 janë kryer 74 rishikime të auditimeve të rregullsisë në të gjitha fazat e auditimit, ku prej tyre 35 rishikime në fazën e planifikimit dhe 39 rishikime në fazën e ekzekutimit. Ndërsa, për sezonin 2019/2020 është planifikuar të rishikohen 57 auditime të rregullsisë. Deri më tani për fazën e planifikimit janë përfunduar 27 rishikime të auditimeve të rregullsisë. Në këtë mënyrë, ZKA-ja sigurohet që të gjitha ekipet e auditimit zbatojnë kërkesat e SNISA-ve, të metodologjisë së auditimit të definuar në doracakët përkatës dhe letrat e punës, si dhe kanë një qasje konsistente në auditim.

Sa i përket auditimeve të performancës, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë është një proces që zbatohet në çdo auditim. Fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit janë subjekt i rishikimit në të gjitha nivelet menaxheriale. Rishikimi kolegjial për draft-raportin e auditimit bëhet nga anëtarët e emëruar brenda divizionit, përpara se të shqyrtohet draft -raporti nga menaxhmenti. Parastudimet dhe draft-raporti rishikohen në mënyrë sistematike, përmes diskutimeve brenda ekipit nga udhëheqësi i departamentit dhe menaxhmenti i lartë. Për disa nga temat janë angazhuar këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë (SNAO), Banka Botërore (BB) dhe në disa raste edhe ekspertë vendorë të fushave përkatëse.

Me ndihmën e ekspertëve të Zyres kombëtare të Auditimit të Suedisë është kryer rishikimi i ftohtë i procesit të auditimeve të rregullsisë dhe atyre të performancës, si dhe janë rishikuar një numër raportesh të auditimit. Rishikimi ka nxjerrë në pah nevojën për përmirësim të mëtejshëm të procesit dhe cilësisë së produkteve të auditimit. Për këtë arsye, ZKA-ja ka përgatitur plane të veprimit për të zbatuar rekomandimet e dhëna në raportet e rishikimit.

1.4 Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse

Treguesi kryesor tek kjo fushë është: **menaxhimi financiar, pasuritë dhe shërbimet mbështetëse**. ZKA-ja, burim kryesor të financimit ka Buxhetin e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, ZKA-ja pranon donacione dhe grante të ndryshme për të mbështetur aktivitetet dhe funksionet e saj. Ndërsa të hyrat që i realizon nga kryerja e auditimeve të projekteve të ndryshme, të financuara kryesisht nga donatorët, derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2019, ZKA-ja ka bashkëpunuar me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, siç janë Banka

Botërore, USAID-i dhe Institucionet Supreme të Auditimit, që në një mënyrë apo tjetër kanë përkrahur ZKA-në në përmbushjen e synimeve strategjike.

1.4.1 Menaxhimi financiar

ZKA-ja zbaton në përpikëri të gjitha rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me menaxhimin financiar dhe kontrollin në Republikën e Kosovës. Me Ligjin e Buxhetit Nr. 06/L-133, mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, ZKA-së i ishte ndarë buxheti në vlerë prej 3,357,792 €, që krahasuar me vitin 2018, ishte më i madh për 20 %. Kjo rritje është më e theksuar kryesisht për faktin se janë ndarë mjete në kategorinë e investimeve kapitale për zhvillimin e softuerit, për menaxhimin e proceseve të auditimit. Sidoqoftë, pas kursimeve të deklaruara, Buxheti final i ZKA-së për 2019 ishte 2,966,193 € ose 8 % më i madh se ai i vitit 2018. Në shumën e mësipërme nuk janë përfshirë mjetet për zbatimin e projektit të financuar nga Banka Botërore "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit", që për vitin 2019, ishte alokuar shuma prej 145,752.25 €.

Në vijim janë paraqitur ndarjet buxhetore dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike:

Pagat dhe mëditjet. Ndarja finale buxhetore për këtë kategori ekonomike është në shumën prej 2,124,593 €. Krahasuar me vitin 2018, ky buxhet është më i madh për 6 %. Në këtë rritje të shpenzimeve, ndikimin kryesor e ka pasur rritja e numrit të punonjësve për pesë. Shpenzimi për këtë kategori ekonomike është i tërësishëm, aq sa edhe ndarja buxhetore.

Mallrat dhe shërbimet. Për këtë kategori, në fillim të vitit janë ndarë 723,100 €, ku përfshihen edhe të hyrat vetanake në shumë prej 20,000 €. Ndërsa, pas deklarimit të kursimeve nga ZKA-ja, Qeveria e Kosovës ka reduktuar shumën prej 63,500€. Ndarja finale buxhetore e kësaj kategorie ekonomike ishte në shumën 659,600 €. Krahasuar me vitin 2018, ndarja finale për këtë kategori ishte më e madhe, për vetëm për 1.3 %. Në fund të vitit 2019, shpenzimi për këtë kategori ishte 614,999 € apo 93 %. Në kuadër të projektit nga Banka Botërore "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit", gjatë vitit 2019 janë realizuar 95,238 €. Ky projekt ka filluar së zbatuari në vitin 2017 dhe vlera e përcaktuar për këtë projekt ishte 164,930 për tri vjet (2017, 2018 dhe 2019). Gjatë këtyrë viteve, nga kjo shumë, janë bërë shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 114,416 €. Këto mjete në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) janë raportuar si shpenzime nga Banka Botërore. Gjatë vitit 2019, në bazë të kërkesave për rimbursim, Banka Botërore ka realizuar rimbursimin e të gjithë shumës së shpenzuar përgjatë tri vjetëve. Projekti ka përfunduar në shtator të vitit 2019.

Gjatë vitit 2019, ZKA-ja ka pasur përkrahje edhe në organizimin e Konferencës së XI-të Vjetore të saj. Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë, përveç përkrahjes profesionale me ekspertë, ka ofruar edhe përkrahje financiare për ZKA-në në shumën prej 10,000€, në organizimin e kësaj ngjarjeje. Këto mjete janë cilësuar si përkraje financiare nga palët e treta. Poashtu, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Ekonomik (OSBE), Misioni në Kosovë, ka ofruar përkrahje duke mbuluar shpenzimet për pjesëmarrësit në Panelin e 2-të të Konferencës "Sfidat në zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe rëndësia e komunikimit efektiv me palët e ineteresit ", në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të mediave, të organizatave të shoqërisë civile dhe të institucioneve publike të Kosovës.

Shërbimet komunale. Në fillim të vitit në këtë kategori është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 50,000 €. Ndërsa, pas deklarimit të kursimeve nga ZKA-ja, Qeveria e Kosovës ka reduktuar shumën prej 15,000 €. Rrjedhimisht, ndarja finale buxhetore ishte në shumën 35,000

€. Krahasuar me vitin 2018, buxheti për këtë kategori ishte më i ulët për 2.6 %. Në fund të vitit 2019, buxheti i shpenzuar ishte në vlerën 33,088 €, ose 95 %.

Investimet kapitale. Ndarja buxhetore për këtë kategori, në fillim të vitit ishte në vlerë prej 487,000 €. Vetëm për projektin "Softuer për Menaxhimin e Auditimit" ndarja buxhetore ishte në shumë prej 400,000€. Për shkak të natyrës komplekse të këtij projekti, gjatë vitit 2019 kemi arritur të zhvillojmë dokumentacionin teknik dhe përmes procedurave të prokurimit kemi lidhur kontratën për zhvillimin e softuerit. Më këtë rast kemi paguar edhe shumën e kontraktuar në formë të avancit në shumë prej 49,537.12€. Pjesën tjetër të mjeteve e kemi deklaruar si kursime buxhetore. Pas kësaj, Qeveria e Kosovës ka reduktuar shumën prej 340,000 €. Buxheti final për këtë kategori në fund të vitit ishte 147,000 €, ndërsa ishin shpenzuar 121,735 € ose 83 %.

Tabela 8. Shpenzimi i buxhetit përgjatë tri vjetët 2017-2019 (në EUR `000)


Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzimit
2019				
Buxheti i përgjithshëm	3,358	2,966	2,895	98%
Pagat dhe mëditjet	2,098	2,125	2,125	100%
Mallrat dhe shërbimet	723	660	615 ¹³	93%
Shërbimet komunale	50	35	33	95%
Investimet kapitale	487	147	122	83%
2018				
Buxheti i përgjithshëm	2,791	2,744	2,697	98%
Pagat dhe mëditjet	2,020	2,003	2,003	100%
Mallrat dhe shërbimet	651	651	613	94%
Shërbimet komunale	45	36	30	89%
Investimet kapitale	75	54	51	95%
2017				
Buxheti i përgjithshëm	2,398	2,366	2,273	96%
Pagat dhe mëditjet	1,768	1,768	1,757	99%
Mallrat dhe shërbimet	551	551	476	86%
Shërbimet komunale	34	34	28	82%
Investimet kapitale	45	13	12	92%

Grafiku 9 paraqet pasqyrën e shpenzimit të buxhetit të ZKA-së gjatë vitit 2019 (pa përfshirë mjetet e projektit të Bankës Botërore). Shpenzimet e realizuara tregojnë Pagat dhe mëditjet si


¹³ Në këtë vlerë nuk janë përfshirë mjetet e projektit të Bankës Botërore.

kategorinë me shpenzimin më të madh të buxhetit prej 73.5 %, derisa Mallrat dhe shërbimet marrin pjesë me 21.5 %¹⁴. Shpenzimet komunale mbesin në nivelin prej 1 %, përderisa investimet kapitale kanë arritur në 4 %. Ndërkaq, Grafiku 8 paraqet trendin e shpenzimeve kryesore të ZKA-së gjatë tri vjetëve të fundit, ku vërehet një rënie e lehtë e shpenzimeve për Pagat dhe mëditjet dhe një rritje e lehtë e shpenzimeve për Mallra dhe shërbime.


Grafiku 8. Trendi i shpenzimeve kryesore (%)



Grafiku 9. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike



Grafiku 10. Shpenzimet kryesore në kategorinë Mallra dhe Shërbime



Grafiku 10 pasqyron shpërndarjen e shpenzimeve të kategorisë ekonomike Mallrat dhe Shërbimet.

- ZKA-ja aktivitetin e saj e kryen në një objekt privat. Edhe pse gjatë vitit 2018, ZKA-ja ka ndërruar lokacion dhe është vendosur në një objekt më të madh, për shkak të rritjes së stafit dhe të portofolios së auditimit, nevojat për hapësirë shtesë janë ende evidente.

¹⁴ Në këtë % vlerë nuk janë përfshirë mjetet e projektit të Bankës Botërore.

Një zgjidhje e përhershme në ndonjë objekt në pronësi publike do të ulte ndjeshëm koston e këtij aktiviteti, që në buxhetin e kësaj kategorie merr pjesë me 27 %.

- Shpenzimet për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit përbëjnë 22 % të shpenzimeve të kategorisë. Këto shpenzime kanë ndodhur si rezultat i rritjes së numrit të auditimeve dhe kryerjes së tyre me burime vetanake në entitetet, të cilat janë larg Prishtinës dhe që kërkojnë qëndrim më të gjatë në terren. Ndikim në këtë lloj të shpenzimeve ka pasur edhe pjesëmarrja e personelit të ZKA-së në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit rajonale e globale, përfshirë aktivitetet lobuese për integrim në institucionin më të lartë ndërkombëtar të auditimit INTOSAI, që ka rezultuar me anëtarësimin e ZKA-së me të drejta të plota në këtë organizatë.
- Pajisjet dhe furnizimet për zyrë përbëjnë 13.5 % të shpenzimeve të kategorisë. Këtu përfshihen pagesat për blerje të pajisjeve dhe furnizime të tjera për nevoja të ZKA-së për vitin 2019.
- Shpenzimet për shërbime, po ashtu marrin pjesë me 13.5 % në shpenzimet e kategorisë. Në këtë lloj të shpenzimeve përfshihen shërbimet intelektuale dhe këshilldhënëse, shërbimet e arsimit dhe trajnimit dhe shërbime kontraktuese të tjera.
- Mirëmbajtja dhe sigurimi tërheqin shpenzimet në masën prej 11 % të buxhetit të kategorisë. Në këtë kuadër përfshihen shpenzimet për mirëmbajtje dhe sigurim të objektit, teknologjisë Informative dhe të veturave zyrtare të ZKA-së.
- Shërbimet e telekomunikimit marrin pjesë me 6 %. Këtu përfshihen shpenzimet e internetit, të telefonsë mobile dhe shpenzimet postare.

1.4.2 Shërbimet mbështetëse

Në kuadër të ZKA-së funksionojnë edhe shërbimet mbështetëse që kryejnë aktivitete në kuadër të Shërbimeve të përbashkëta, Teknologjisë Informative dhe Prokurimit.

Shërbimet e përbashkëta. Në kuadër të Departamentit të Shërbimeve të Përbashkëta, divizionet përkatëse ofrojnë shërbime administrative, përkatësisht administrimin e dokumenteve dhe shërbime logjistike. Në administrimin e dokumenteve, në bashkëveprim me Departamentin e Teknologjisë Informative është bërë avancimi i formave për menaxhimin elektronik të dokumenteve, sidomos në formën e arkivimit elektronik. Përmes platformës elektronike, auditorët kanë qasje në dokumentet e arkivuara, të cilat janë të nevojshme për punët vijuese në auditim.

Në kuadër të shërbimeve logjistike, janë bërë avancime në kompletimin e rregullativës për menaxhimin e pasurive jofinanciare; është bërë regjistrimi i të gjitha pasurive në sistemet përkatëse; inventarizimi i plotë i pasurisë; vlerësimi i tyre, si dhe tjetërsimi i pasurive jashtë përdorimit. ZKA-ja ka kapacitete të kufizuara teknike dhe njerëzore në kuadër të shërbimeve të transportit. Nisur nga kjo, gjatë vitit 2019 janë rritur kapacitetet transportuese me dy automjete të reja.

Meqenëse kryerja e aktiviteteve audituese dhe raportimi është i lidhur me afate ligjore dhe me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të kohës për punë audituese në terren, si dhe të rritjes së efikasitetit të shërbimeve për transportin e punonjësve auditues në selinë e entiteteve për kryerjen e auditimit, është azhurnuar akti i brendshëm që rregullon çështjen e transportit të auditorëve dhe të qëndrimit të tyre në terren.

Teknologjia Informative. Trendi i ndryshimeve në fushën e Teknologjisë Informative (TI) është shumë i shpejtë dhe nevojat për përcjelljen e tyre janë të domosdoshme. Lidhur me këtë, në kuadër të Departamentit për Teknologji Informative, përveç punëve të rregullta në funksionalizimin dhe operimin e pajisjeve dhe mirëmbajtjes së tyre, si aktivitete të veçanta janë zhvilluar:

- Rifreskimi i Infrastruktues së TI-së, përkatësisht është bërë rifreskimi i 30 % të serverëve të infrastrukturës së TI-së dhe është shtuar hapësira për ruajtjen e dokumenteve dhe postës elektronike.
- Janë futur në zbatim teknologjitë e reja për mbrojtjen dhe sigurinë e rrjetit të brendshëm të ZKA-së, të cilat azhurohen në mënyrë inteligjente sapo të dalin funksionet më të reja të sigurisë.
- Te disa shfrytëzues është instaluar dhe ka filluar përdorimi i pakos së re të “Offices 365” që ofron mundësi shumë të mira të bashkëpunimit dhe komunikimit në mes stafit. Me këtë paketë është mundësuar që dokumentet të ruhen në “cloud” ku mundësohet qasja nga secila pajisje.
- Janë koordinuar aktivitetet së bashku me Departamentin për Shërbime të Përbashkëta, lidhur me avancimin e formave përkatëse për menaxhimin elektronik të dokumenteve.

Për të përvetësuar ndryshimet dhe zhvillimet e reja në fushën e TI-së, ZKA-ja, rëndësi i ka kushtuar edhe zhvillimit profesional të punonjësve të TI-së konform këtyre nevojave. Punonjësve të TI-së u është mundësuar pjesëmarrja në trajnimin “IT Infrastructure Library – ITIL” dhe marrja e çertifikatës përkatëse për personelin profesional të TI-së.

Përkundër kësaj, sfidë e vazhdueshme mbetet nevoja për investime në teknologji të reja, si dhe në azhurnimin e njohurive, mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial, meqenëse përdorimi i mediave sociale dhe pajisjeve mobile bartë rrezik më vete. Po ashtu edhe menaxhimi i pajisjeve, të cilat janë gjithmonë e më shumë mobile, si dhe menaxhimi i kapacitetit të infomacionit i cili vazhdimisht shtohet në përmasa të mëdha do të jenë sfidë për Departamentin e TI-së.

Prokurimi. Në kuadër të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2019, kryesisht është punuar sipas Planit Vjetor të Prokurimit, të miratuar në përputhje me Ligjin përkatës për Buxhetin. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar gjithsej 47 aktivitete të prokurimit, të cilat kryesisht kanë qenë furnizime dhe kryerje të shërbimeve.

Si aktivitet i veçantë vlenë të përmendet procesi i prokurimit për “Zhvillimin e Softuerit për Menaxhimin e Auditimit – SMA”. Ky aktivitet i përcaktuar në kuadër të shpenzimeve kapitale, ka rezultuar me sukses, përkatësisht me lidhjen e kontratës me operatorin fitues dhe realizimi i SMA-së duhet të përfundojë brenda vitit 2020. Ky softuer do të lehtëson shumë menaxhimin e procesit të auditimit dhe të dokumentacionit auditues, do të rris efikasitetin në punë, do të kursej kohën për angazhimet teknike rreth auditimit dhe mbi të gjitha do të rris sigurinë e informatave për punën audituese.

1.5 Menaxhimi i Burimeve njerëzore

Treguesit kryesorë të kësaj fushë janë: **menaxhimi i burimeve njerëzore** dhe **zhvillimi profesional**.

1.5.1 Burimet njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka rol thelbësor në ecurinë e suksesshme të ZKA-së. Gjatë vitit 2019 ZKA-ja ka ndërmarrë një sërë aktivitete që ndërlidhen me marrëdhënien e punës, zhvillimin profesional, mirëqenien në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të saj.

Me Ligjin për Buxhetin e vitit 2019, ZKA-ja kishte të miratuara 172 pozita të punës. Në fund të vitit 2019, ZKA-ja ka pasur gjithsej 171 punonjës, prej tyre 141 ose 83 % personel auditues, përfshirë pozitat drejtuese, ndërsa pjesa tjetër prej 30 punonjësve apo 17 % janë shërbyes civil dhe personel mbështetës.

Rekrutimet. Gjatë vitit 2019, ZKA-ja ka angazhuar nëntë punonjës të rinj, derisa punën e kanë lëshuar tre punonjës. Rrjedhimisht, numri i punonjësve në ZKA është rritur për gjashtë në krahasim me vitin 2018. Dy prej punonjësve të rinj janë angazhuar përmes programit "Young Cell Scheme", pasi kemi pranuar një listë me kandidatë potencial nga Ministria e Integritetit Evropian. Për angazhimin e tyre është zhvilluar një procedurë e testimit të aftësive të përgjithshme dhe të testimit të aftësive profesionale.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 12 procese të promovimit të brendshëm. Këto procese janë realizuar kryesisht në fushën e auditimit, duke iu dhënë mundësinë të gjithë personelit të ZKA-së, që kanë plotësuar kushtet e promovimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Proces i veçantë është zhvilluar për angazhimin e përkohshëm të përkthyesve për përkthimin e raporteve të auditimit në periudhën Prill-Qershor 2019. Këta persona janë angazhuar në cilësinë e kryesve të shërbimeve dhe të njëjtit me përfundimin e punës së përcaktuar kanë përfunduar edhe angazhimin e tyre në ZKA.

Tabela 9 paraqet të dhënat rreth punonjësve, ku përfshihet numri i përgjithshëm i punonjësve, përqindja e gjinisë femërore, moshë mesatare në ZKA, numri i punonjësve nga komunitetet si dhe përqindja e lëvizjeve/largimeve të punonjësve në vitin 2019. Në krahasim me vitin 2017, numri i punonjësve në ZKA është rritur për 12 sish, ose marrë në përqindje kjo rritje është mesatarisht 3.7 % në vit, për dy vjetët e fundit. Edhe përkundër kësaj rritjeje, ende mbetet sfida mbulimi i të gjitha obligimeve ligjore audituese dhe aktiviteteve përcjellëse të ZKA-së.

Struktura gjinore ka pasur një ndryshim prej mbi 2 % në favor të gjinisë femërore. Në këtë rritje kanë ndikuar, si rekrutimi i punonjësve të rinj, ashtu edhe largimi i tre punonjësve të gjinisë mashkullore. Moshë mesatare e punonjësve ka një rritje të lehtë nga viti i kaluar, derisa 79% e punonjësve të ZKA-së janë të moshës së mesme prej 31 deri në 50 vjet, ajo e shtyrë prej 51 deri në 65 vjet është 16 %, kurse moshë e re nën 30 vjet është në përqindje prej 5 %.

Numri i punonjësve nga komunitetet nuk ka pësuar ndryshim. Edhe përkundër përpjekjeve për të tërhequr më shumë kandidatë nga komunitetet, interesimi për punësim në ZKA nga këto grupe etnike mbetet i vogël.

Tabela 9: Ndryshimet në personelin e ZKA-së, përgjatë tri viteve të fundit

Viti	Nr. i personelit në fund të vitit (numër)	Personeli femëror (%)	Mosha Mesatare (vite)	Personel nga komunitetet (numër)	Lëvizja e personelit (%)
2019	171	53	42.2	4	1.75
2018	165	51	40.4	4	1.80
2017	159	50	39.6	4	2.50

Tabela 10 prezanton strukturën gjinore në pozitat menaxheriale në ZKA. Këtu përfshihen, nivelet drejtuese, niveli i mesëm dhe pozitat e udhëheqësve të ekipeve të auditimit¹⁵. Në vitin 2019, numri i femrave në pozita menaxheriale në krahasim me vitin e kaluar është rritur për 9 %, kryesisht në nivelin e udhëheqësve të ekipeve.

Tabela 10: Pozitat drejtuese sipas gjinisë në të gjitha funksionet

Viti	Gjithsej femra në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %	Gjithsej meshkuj në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %
2019	39	53	34	47
2018	32	44	40	56
2017	33	46	39	54

1.5.2 Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit

Duke qenë të vetëdijshëm se trajnimi është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të institucionit, ZKA-ja ka shtrirë vëmendjen në të gjitha fushat e interesit që synojnë ndërtimin e një qasjeje më gjithëpërfshirëse dhe profesionale. Në këtë sfond, zhvillimi profesional dhe aftësia në rritje e punonjësve të ZKA-së për të përmbushur kërkesat dhe kriteret e vendosura nga INTOSAI paraqesin bazë për të vlerësuar performancën dhe pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për ISA-të.

Duke kuptuar rëndësinë e investimit në këtë fushë, në periudhën e fundit të vitit, ZKA-ja ka arritur marrëveshje me shoqata profesionale për ofrimin e sesioneve trajnuese për të gjithë auditorët financiar, për forcimin e mëtejshëm të kompetencës në punë. Tashmë, për çdo vit, punonjësit e ZKA-së do t'i nënshtrohen mbajtjes së trajnimeve obligative në edukimin e vazhdueshëm profesional (EVP) dhe enkas për këtë qëllim, është paraparë të angazhohet një këshilltar për zhvillim profesional, i cili përveç tjerash do të mbikëqyr edhe mbarëvajtjen e këtij procesi dhe bashkëpunimin me shoqatat.

Gjatë vitit 2019, janë mbajtur një sërë aktivitetesh që ndërlidhen me zhvillimin profesional dhe trajnimin. Përveç, trajnimeve të brendshme, punonjësit e ZKA-së kanë përfituar edhe nga trajnimet e ofruara nga institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare. Është vazhduar me planin vjetor të trajnimeve, që rregullisht mbahen në muajt janar, shkurt, korrik dhe gusht. Këto periudha njihen si më të përshtatshme pasi që janë jashtë fazës intensive të procesit auditues dhe me qëllim të maksimizimit të kohës, shfrytëzohen për qëllime të mbajtjes së trajnimeve.

¹⁵ Pozita e udhëheqësit të ekipit është me mandat njëvjeçar dhe është subjekt i ndryshimeve për çdo vit, varësisht nga nevojat e Planit Vjetor të Auditimit.

Trajnime profesionale janë mbajtur edhe për personelin mbështetës në fushat përkatëse. Trajnimet për këtë kategori të punonjësve planifikohen dhe organizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil të Republikës së Kosovës.

Trajnime për stafin e ZKA-së kanë ofruar edhe partnerët e jashtëm, si nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë, Zyra Kombëtare e Auditimit e Polonisë, Institucioni Suprem i Auditimit të SHBA-ve, Gjykata Evropiane e Auditorëve, Banka Botërore, USAID-i, etj.

Programi profesional për auditorët e performancës. Gjatë vitit 2019, në bashëpunim me SNAO-n është zhvilluar trajnimi profesional për të gjithë auditorët e performances në ZKA. Programi ka përfshirë një "modul e-learning", seminare dhe detyra praktike. Për të marrë pjesë në program, të gjithë auditorët është dashur të jenë pjesë e një ekipi të auditimit, që nga faza e para-studimit deri në finalizimin e raportit të auditimit. Në fund të programit, të gjithë auditorët iu kanë nënshtruar testit me shkrim, i cili është përgatitur bashkërisht me ekspertët e SNAO-s. Tetëmbëdhjetë auditorë të performances, përfshirë edhe tre menaxherë kanë marrë pjesë dhe e kanë kryer me sukses programin e trajnimit, si dhe janë pajisur me certifikata të nënshkuara nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës dhe ai i Suedisë.

Punëtorja Simulimi i politikave. Në bashkëpunim me Univerzitetin e Kembrixhit dhe Kolegjin UBT-së, ZKA-ja ka zhvilluar punëtorinë "Simulimi i politikave", ku rast studimi ka qenë Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Një grup i përzier i auditorëve të performances dhe atyre financiar kanë marrë pjesë në këtë punëtori, e cila është moderuar nga profesorë të Univerzitetit të Kembrixhit dhe të Kolegjit UBT. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë përfaqësues nga sektori i shëndetësisë dhe të organizatave të shoqërisë civile.

Sistematizimi i pozitave audituese. Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe në bazë të akteve të brendshme normative, për fushat e Auditimit të Rregullsisë dhe të Performancës, ZKA-ja ka vendosur tri nivele profesionale: Auditor Senior, Auditor dhe Auditor Junior. Ndërkaq, në kuadër të Departamentit të Metodologjisë në Auditim të ZKA-së është caktuar funksioni i Auditorit specialist.

Me aktet e brendshme të ZKA-së janë themeluar edhe pozita të tjera profesionale, si: Auditor Senior i TI-së, Auditor i TI-së, Auditor i lartë ligjor, Auditor ligjor, etj.

Fotogaleria 1. Trajnimet



1. Trajnimi "Performanca në ekip" i realizuar me SNAO. 2. Trajnimi për prokurorët e rinj.

1.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit

Edhe gjatë vitit 2019, ZKA-ja ka pasur një komunikim të vazhdueshëm dhe ka avancuar marrëdhëniet me palët e interesit. ZKA-ja ka zhvilluar më tutje qasjen gjithëpërfshirëse, duke qenë nikoqire dhe pjesëmarrëse në shumë takime, punëtori e konferenca brenda dhe jashtë vendit. Përderisa **në rrafshin kombëtar** është forcuar më tej partneriteti me komisionet parlamentare dhe organizatat e shoqërisë civile, **aktiviteti ndërkombëtar** ka kulmuar me anëtarësimin e ZKA-së me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

1.6.1 Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjqësorin

ZKA-ja gjatë vitit 2019 ka intensifikuar bashkëpunimin me Kuvendin e Republikës së Kosovës, përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa (KBF). Sipas nevojës, AP-ja ka mbajtur takime të veçanta me kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe drejtuesit dhe anëtarët e KMFP-së dhe KBF-së. Me përkrahje nga GIZ-i është mbajtur një takim i përbashkët i anëtarëve të këtyre dy komisioneve dhe përfaqësuesve të ZKA-së, për të diskutuar në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA-së për Komisionet parlamentare. Më konkretisht, përgatitja e materialeve për trajtimet e raporteve të auditimit. Po ashtu, AP-ja ka prezantuar para KMFP-së dhe KBF-së, Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së për vitin 2018, së bashku me Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara.

ZKA-ja ka përgatitur rregullisht për KMFP-në dhe KBF-në informatat e nevojshme dhe përmbledhjet për raportet e auditimeve të kryera, si dhe u ka ofruar deputetëve këshillat e nevojshme në lidhje me raportet e auditimit që diskutohen në komisionet parlamentare. Përgjatë periudhës Janar-Korrik 2019, sa ishte funksional KMFP-ja, ka shqyrtuar 10 raporte të auditimit, prej tyre katër të rregullsisë së organizatave buxhetore, katër të ndërmarrjeve publike dhe dy raporte të auditimit të performancës. Gjithashtu është shqyrtuar edhe Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së për vitin 2018.. Ndërsa, KBF-ja, në rastet kur ka shqyrtuar raportet financiare të OB-ve, ka ftuar përfaqësues të ZKA-së për të prezantuar raportet e auditimit.

Për shkak të mosfunksionimit të Kuvendit, AP-ja nuk ka pasur mundësi që t'ua prezantojë deputetëve në seancë plenare gjetjet dhe rekomandimet nga Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2018.

Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit mes Parlamenteve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) për përmirësimin e performancës së auditimit të jashtëm janë organizuar disa konferenca rajonale, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës (KMFP-ja dhe KBF-ja) dhe ZKA-ja. Dy prej këtyre konferencave: "Fuqizimi i marrëdhënieve të Parlamentit dhe ISA-ve për të përmirësuar performancën e auditimit të jashtëm në Shtetet e Ballkanit Perëndimor", i mbajtur në Tiranë, në Maj 2019; dhe "Strategjitë dhe qasjet teknike për përforsimin e bashkëpunimit mes Parlamenteve dhe ISA-ve", i mbajtur Podgoricë në Nëntor 2019, janë organizuar nga Banka Botërore dhe OECD/SIGMA. Konferencën Rajonale "Bashkëpunimi në mes të Zyrës Shtetërore të Auditimit dhe Parlamentit", të mbajtur në Shkup, në mars 2019 e ka organizuar Zyra Shtetërore e Auditimit e Maqedonisë së Veriut. Ndërsa, konferenca "Mbikëqyrja Parlamentare e Financave Publike", e mbajtur në Prishtinë, në Maj 2019, është organizuar nga KMFP-ja e Kosovës në bashkëpunim me GIZ-in.

Fotogaleria 2. Konferencat rajonale "Fuqizimi i bashkëpunimit mes Parlamenteve dhe ISA-ve"



1. Konferenca e mbajtur në Shkup. 2. Konferenca e mbajtur në Prishtinë. 3. Konferenca e mbajtur në Tiranë. 4. Konferenca e mbajtur në Podgoricë.

Bashkëpunimi me përfaqësuesit e lartë të institucioneve publike të vendit ka vazhduar përmes komunikimit të rregullt dhe takimeve sipas nevojës, ku janë prezantuar çështjet kryesore të auditimit për vitin 2018 dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit. Brenda kompetencave institucionale, kujdes i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit profesional me Thesarin. Komunikimi i rregullt ndërmjet dy institucioneve ka bërë që të evidentohen me kohë dhe të shmangen një sërë gabimesh në Raportimin Financiar të OB-ve.

Me qëllim të rritjes së ndikimit të auditimit të jashtëm dhe rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm nga komunat e Kosovës janë zhvilluar disa aktivitete:

- Ashtu sikur edhe në vitin e kaluar, Menaxhmenti i ZKA-së ka marrë pjesë në të gjitha debatet e organizuara nga Organizata BIRN, në kuvendet komunale të Mitrovicës, Ferizajit, Podujevës, Malishevës dhe Rahovecit, ku në prezencë të kryetarit të komunës, të këshilltarëve komunal, të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të mediave është diskutuar për progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditimit.
- Në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ZKA-ja ka organizuar tri punëtori ndër-rajonale në komunat e Kosovës.
- AP-ja ka marrë pjesë edhe në konferenca dhe tryeza, ku është diskutuar lidhur me qeverisjen lokale, rolin e raporteve të auditimit dhe rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve.

Fotogaleria 3. Konferencat me partnerë



1. Konferenca e përbashkët e ZKA-së me Avokatin e Popullit. 2. Punëtori me pushtetin lokal organizuar me OSBE-në

AP-ja, përmes Njësisë së ZKA-së për Luftimin e Mashtrimit ka pasur bashkëpunim të rregullt institucional edhe me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit, si me: **Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit**, duke e informuar në lidhje me rastet indikative me elemente të veprave penale, të cilat hasen gjatë punës audituese; **Agjencinë Kundër Korrupsionit**, duke ofruar informata shtesë dhe sqarime sipas nevojës lidhur me trajtimin e gjetjeve në raportet e auditimit; dhe **Policinë e Kosovës**, duke i ofruar të dhëna dhe dokumente relevante, të siguruara në proceset e auditimit për rastet e caktuara, të cilat trajtohen nga hetuesia. Në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit, ZKA-ja vepron në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin kombëtar të fushës penale. Poashtu, AP-ja ka kultivuar komunikim konstruktiv ndër-institucional edhe me **Institucionin e Avokatit të Popullit**.

1.6.2 Komunikimi me Mediat, Qytetarët, Organizatat e Shoqërisë Civile, Donatorët dhe akterë të tjerë

Gjatë vitit 2019 komunikimi dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile është avancuar përmes takimeve periodike, informimit të vazhdueshëm dhe prezantimit publik të raporteve të auditimit të performancës. Gjatë vitit 2019 janë prezantuar pesë raporte të auditimit të performancës: "Zhvillimi i Kapaciteteve në Procesin e Bërjes së Politikave dhe Koordinimit" - Prill 2019; "Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës" -

Nëntor 2019; "Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore" - Nëntor 2019; "Siguria në trafikun rrugor" - Dhjetor 2019; dhe "Siguria e Ushqimit, rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit" - Dhjetor 2019.

Në shtator 2019, ZKA-ja ka organizuar tryezë me shoqërinë civile dhe shoqatat profesionale të auditimit me qëllim të identifikimit dhe diskutimit të temave relevante dhe me prioritet që do të përfshihen në planin vjetor për auditime të performancës.

Mbështetje e vazhdueshme është dhënë edhe në ofrimin e informatave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile përmes pyetësorëve dhe anketave për qëllime të analizave dhe studimeve të tyre, si dhe pjesëmarrjes në konferenca e punëtori.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe komunikimit me media dhe qytetarë. AP-ja ka mbajtur disa konferenca dhe takime me gazetarë, me ç'rast është rritur numri i raportimeve në media për punën dhe raportet e ZKA-së. Gjatë vitit është funksionalizuar edhe Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, përmes së cilit synohet që puna dhe rezultatet e auditimit të jenë më afër qytetarëve. Ndërkaq me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë Holandeze, Rrjetit të Gazetarisë Hulumtuese në Ballkan-BIRN Kosova, si dhe në bashkëpunim me ACDC-në, ka filluar zbatimi i projektit "Promovimi i rolit të Auditorit të Përgjithshëm/ZKA-së në Kosovë".

Fotogaleria 4. Takimet me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Mediat



1. Tryeza me OSHC-të. 2. Zbatimi i projektit me BIRN.

Me rastin e fillimit zyrtar të punës së Njesisë për Luftimin e Mashtrimit, e cila vepron në kuadër të Departamentit për Çështje Ligjore në Auditim të ZKA-së, më 19 mars 2019, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë (ShBA), Philip S. Kosnett, ka vizituar ZKA-në dhe bashkë me AP-në, Besnik Osmani e kanë inauguruar fillimin e punës së kësaj Njësie. Projekti i USAID-it, "Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM)" e ka përkrahur ZKA-në në përgatitjen e doracakëve dhe trajnimin profesional të personelit për identifikimin e rasteve të mashtrimit gjatë procesit të auditimit.

ZKA-ja ka pasur bashkëpunim të mirë edhe me institucionet e tjera vendore. Në vitin 2019 janë shtuar aktivitetet për përfshirjen e institucioneve akademike e shkencore për avancimin e kualifikimeve profesionale të auditorëve. Siç u theksua më lartë janë bërë aranzhimet e nevojshme me shoqatat profesionale për ofrimin e sesioneve për edukimin e vazhdueshëm profesional të auditorëve financiar. Ndërkaq, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të ZKA-së dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" kanë filluar punën praktike grupi i parë i studentëve.

ZKA-ja ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe organizatat donatore në Kosovë, në veçanti: Zyrën e BE-së në Kosovë, USAID-in, Bankën Botërore, OSBE-në, GIZ-in, Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, etj.

1.6.3 Bashkëpunimi me ISA-të partnere, marrëveshjet bilaterale, takimet e vizitat

ZKA-ja është fokusuar në ruajtjen e marrëdhënieve dhe avancimin e bashkëpunimit me organizatat homologe në rajon dhe më gjerë. Gjatë vitit 2019, AP-ja, Besnik Osmani, ka nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunim bilateral me Zyrën Supreme të Auditimit të Republikës së Çekisë, si dhe me Entin Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

AP-ja, Besnik Osmani dhe Zv-AP-ja, Ilir Salihu kanë marrë pjesë në takimin vjetor të Komitetit të INTOSAI-it për Ngritje të Kapaciteteve, të mbajtur në Tokio të Japonisë. Me këtë rast, delegacioni i ZKA-së ka zhvilluar takime të veçanta me Auditorin e Përgjithshëm të ShBA-ve, Gene Dodaro, atë të Japonisë, Dr. Mari Kobayashi, të Suedisë, Helena Lindberg, të Arabisë Saudite, Al-Angari, të Kuvajtit, Adel Al-Saraëi, Drejtorin e Përgjithshëm të Iniciativës për Zhvillim të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (IDI – INTOSAI) Einar Gorrissen, si dhe me Zëvendës-kryesuesin e Komitetit të INTOSAI-t për Ngritje të Kapaciteteve, Magnus Lindell, me të cilët ka biseduar për integrimin e ZKA-së në instancat rajonale e globale të auditimit.

Në nëntor 2019, AP-ja ka vizituar selinë e Gjykatës Evropiane të Auditorëve (ECA) ku është pritur në takim të veçantë nga z. Klaus Lehne, President i ECA-s, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin institucional, me theks të veçantë për pjesëmarrjen e personelit të ZKA-së në programet e ECA-s për praktikë profesionale, si dhe për integrimin e ZKA-së në organizatat evropiane të auditimit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019, ZKA-ja ka thelluar më tej bashkëpunimin me ISA-n e Republikës së Çekisë, të Polonisë, të Kroacisë, të Emirateve të Bashkuara Arabepërmes shkëmbimeve bilaterale dhe realizimin e vizitave zyrtare.

Personeli i ZKA-së ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, grupe punuese të auditimit në kuadër të bashkëpunimit bilateral dhe rajonal, si dhe në aktivitete të ndryshme të organizatave profesionale, si:

- ✓ Takimi i Dytë i Aleancës së Auditorëve
- ✓ Konferenca "Zhvillimi i Kapaciteteve të Kontabilitetit në ekonomitë në zhvillim"
- ✓ Shkëmbimi i përvojave me auditorët suedezë dhe palestinezë
- ✓ Punëtoritë për auditimin e pajtueshmërisë – shkëmbimi i përvojave në mes të ISA-ve të Kosovës, Malit të Zi dhe Bosnje e Hercegovinës
- ✓ Vizita studimore në ZKA të Bullgarisë
- ✓ Punëtorja "Auditimi Dixhital"
- ✓ Seminari për Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave
- ✓ Punëtorja "Çmimi ekonomikisht më i favorshëm – çfarë më tutje?"
- ✓ Punëtoritë me temën "Sigurimi i cilësisë në auditim", në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të ZKA-së dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit Shqiptar.

Projekti i Bashkëpunimit me ISA-n e Suedisë

Në dhjetor 2019, është mbajtur takimi vjetor i Komitetit Drejtues të projektit të bashkëpunimit në mes të ZKA-së dhe Zyres Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit 2019 janë realizuar një sërë aktivitetesh, në fusha të ndryshme si: Programi për Menaxhim dhe Leadership, Programi i trajnimit profesional për auditorët e performances, rishikimi i procesit të auditimeve të rregullsisë dhe të performances, etj.

Vlerësimi i përgjithshëm i Komitetit ishte që gjatë vitit 2019 janë realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet e parapara me Planin Vjetor, si dhe janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera me kërkesën e ZKA-së. Palët janë pajtuar që të vazhdohet projekti i bashkëpunimit përtej vitit 2020, ndërkaq para vazhdimit të Marrëveshjes të bëhet vlerësimi i nevojave të ZKA-së, duke përdorur Kornizën për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit.

Projekti i Binjakëzimit me ISA-n e Polonisë

Me përkrahjen e Bashkimit Evropian, në shtator të vitit 2019, ZKA-ja ka filluar zbatimin e Projektit të Binjakëzimit "Forcimi i mëturshëm i ndikimit të ZKA-së", i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë (NIK). Ky projekt do të zgjasë 18 muaj dhe përbëhet nga tri komponente kryesore: 1. Komunikimi me qytetarët, Parlamentin dhe palët e tjera të interesit; 2. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të ZKA-së; dhe 3. Përditësimi i doracakëve të auditimit (financiar dhe të pajtueshmërisë) dhe letrave të punës, në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.

Gjatë vitit 2019 është vendosur në selinë e ZKA-së Këshilltari resident dhe janë realizuar misionet e para që janë fokusuar kryesisht në komponentin e 3-të.

Fotogaleria 5. Takimet me partnerët ndërkombëtarë



1. Takimi me Presidentin e Gjykatës Evropiane të Auditorëve. 2. Takimi me Auditorin e Përgjithshëm të SHBA-ve.

1.6.4 Anëtarësimi i ZKA-së në INTOSAI

Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës gjatë viti 2019 ka arritur të realizojë një prej objektivave të rëndësishme strategjike të saj, duke u anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), me të drejta të plota.

Anëtarësimi i kanë paraprirë një mori aktivitetesh, arritjesh profesionale, bashkëpunimesh e projektsh të shënuara për më shumë se një dekadë e gjysmë. Pas një procesi të gjatë promovues dhe lobues në arenën ndërkombëtare, më 8 maj të vitit 2018 Zyra Kombëtare e Auditimit aplikoi për anëtarësim në INTOSAI. Kërkesa u ekzaminua nga Sekretariati i

Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe më pas u paraqit në Bordin Drejtues të INTOSAI-t, gjatë Takimit të 71-të, të mbajtur në 15 dhe 16 nëntor 2018 në Moskë të Rusisë. Pas shqyrtimit të aplikimit të ISA-së Kosovës, Bordi Drejtues i INTOSAI-t vendosi të shtyjë vendimin në lidhje me kërkesën për anëtarësim të plotë në INTOSAI deri në Takimin e 72, që ishte planifikuar të mbahej në shtator 2019, në Moskë, Rusi. Shtyrja, siç u konstatua nga bordi u bë për të siguruar informata shtesë në lidhje me aplikimin e ISA-së Kosovës.

Gjatë muajit gusht 2019, anëtarët e Bordit drejtues, përmes votimit me shkrim, kanë vendosur për pranimin e Zyres Kombëtare të Auditimit në INTOSAI, me të drejta të plota. Vendimi për anëtarësim u konfirmua në Takimin e 72-të të Bordit Drejtues që u mbajt me 23 dhe 24 shtator 2019. Një ditë më pas me këtë vendim u informua edhe Kongresi i 23-të i INTOSAI-t që u mbajt në Moskë. Në këtë Kongres, ISA i Federatës Ruse mori kryesimin e INTOSAI-t deri në Kongresin e 24-të.

Anëtarësimi në INTOSAI e bën Zyren Kombëtare të Auditimit partner të barabartë dhe vendimmarrës në rrafshin ndërkombëtar.

1.6.5 Konferenca e XI-të Vjetore e ZKA-së

Në tetor të vitit 2019 ZKA-ja ka mbajtur Konferencën e XI-të Vjetore me temën qendrore "Rritja e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik". Në kuadër të kësaj konference janë mbajtur dy punëtori me tërë personelin "Menaxhimi i cilësisë në auditim dhe proceseve në ZKA" dhe "Menaxhimi i ndryshimit organizativ", përmes së cilave janë marrë inputet drejtpërdrejt nga personeli.

Ndërkaq, me pjesëmarrësit e jashtëm janë zhvilluar dy panele: 1. "Rritja e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik" dhe 2. "Sfidat në zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe rëndësia e komunikimit efektiv me palët e interesit". Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit të Suedisë, Polonisë, Turqisë, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Po ashtu, të pranishëm kanë qenë edhe përfaqësuesit e OSBE-së, të institucioneve publike të Kosovës, ish-anëtarë të komisioneve parlamentare, të shoqërisë civile dhe të mediave.

Fotogaleria 6. Konferenca e XI-të Vjetore e ZKA-së



2 Fokusi i aktiviteteve gjatë vitit 2020

Në funksion të zbatimit të qëllimeve strategjike të rivijëzuara në Planin Strategjik, gjatë vitit 2020 ZKA-ja do të vazhdojë fokusin në fushat dhe aktivitetet në vijim, disa prej të cilave kanë filluar së realizuari gjatë vitit 2019:

Qëllimi 1: Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të ZKA-së, në përputhje me SNISA-të

- Inicimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore, në përputhje me SNISA-të
- Përditësimi i dokumenteve të metodologjisë së auditimit
- Zhvillimi i mëtejshëm i metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik
- Kontraktimi i softverit për menaxhimin e auditimit

Qëllimi 2: Zhvillimi dhe forcimi i kapacitetit institucional për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative

- Ngritja dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale të personelit për zbatimin e Planit Strategjik
- Forcimi i mëtejshëm i kontroleve të brendshme institucionale
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme dhe mjeteve të nevojshme për punë

Qëllimi 3: Komunikimi, integrimi, ndikimi

- Hartimi i Strategjisë për Komunikim Efektiv me palët e jashtme dhe publikun, shoqërinë civile dhe mediat
- Intensifikimi i komunikimit me komisionet parlamentare
- Përcjellja e progresit në zbatimin e rekomandimeve dhe publikimi i bazës së të dhënave për rekomandimet e paadresuara
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit dhe angazhimi për anëtarësimin e ZKA-së në organizatat rajonale e globale

3 Llogaridhënia e ZKA-së

Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, ju siguroj se informatat në Raportin Vjetor të Performancës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, përfshirë Pasqyrat Vjetore Financiare janë të sakta, të besueshme dhe objektive.

Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, ju siguroj se puna jonë gjatë vitit 2019 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Publik dhe Kodin e Mirësjelljes së ZKA-së.

Besnik Osmani,

Auditor i Përgjithshëm

SHTOJCAT

Shtojca 1: Portofoli i auditimeve për sezonin 2018/19 dhe 2019/20

Në sezonin e auditimit 2018/2019 janë publikuar **128 raporte** të auditimit, si në vijim:

115 raporte të auditimit të rregullsisë, për:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës, të vitit 2018
- Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Kryeministrit
- 21 Ministri
- 38 Komuna
- 30 Institucione të pavarura, si dhe Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore¹⁶ të Kosovës
- 11 Ndërmarrje Publike:
 - Trainkos sh.a
 - Hortikultura sh.a Prishtinë
 - KUR Drini i Bardhë sh.a
 - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a
 - KUR Hidroregjioni Jugor sh.a
 - Stacioni i Autobusëve sh.a – Prishtinë
 - KRM Uniteti sh.a
 - KUR Prishtina sh.a
 - Telekom i Kosovës sh.a (hera e parë)
 - Posta e Kosovës sh.a (hera e parë), dhe
 - KRM Pastrimi sh.a, Prishtinë (hera e parë)
- 9 projekte të financuara nga donatorët:
 - Zhvillimi rural dhe agrobujqësor (MBPZHR)
 - Regjistrimi i të dhënave shtetërore kadastrale (AKK)
 - Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ të Kosovës (MASHT)
 - Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH)
 - Eficienca e energjisë së ripërtëritshme (MZHE)
 - Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MTI)
 - Statistikat në vendimmarrje në Kosovë (ASK)
 - Programi Mjedisor i Kosovës, PMK 2016-2020 (MMPH-SIDA), si dhe
 - Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë (ZKM-SIDA)

¹⁶ Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë agjenci ekzekutive të Ministrisë së Financave, PVF-të e tyre integrohen brenda PVF-ve të MF-së. Mirëpo, për shkak se 80 % e të hyrave të BK-së mbledhen prej tyre, ato janë audituar ndaras nga PFV-të e MF-së.

13 auditime të performancës (për fusha të ndryshme, TI, prokurim, projekte)

- Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve
- Ngritja e kapaciteteve në fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave
- Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjetës
- Mirëmbajtja në institucionet e arsimit fillor
- Siguria në trafikun rrugor
- Procesi i menaxhimit të granteve, subvencioneve në sektorin e bujqësisë
- Siguria e Ushqimit - Rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit
- Ndarja e tenderëve në lloje
- Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit
- Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njohimit për kontratë
- Projektet e financuara nga grantet e DEMOS për vitin 2018
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018 – 2020 në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës dhe
- Tregues të performancës për nivelin lokal të qeverisë 2018

* * *

Ndërsa, për sezonin e auditimit 2019/2020, i cili ka filluar në shtator të vitit 2019, ZKA-ja planifikon të përfundojë 132 raporte të auditimit, si në vijim:

119 raporte të auditimit të rregullsisë, për:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2019
- Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Kryeministrit
- 21 Ministri
- 38 Komuna
- 31 Institucione të pavarura, si dhe Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore¹⁷ të Kosovës
- 14 Ndërmarrje Publike:
 - Trainkos sh.a
 - Hortikultura sh.a Prishtinë
 - KUR Drini i Bardhë sh.a
 - KUR Hidromorava (hera e parë)
 - KUR Bifurkacioni (hera e parë)
 - Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës (hera e parë)

¹⁷ Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë agjenci ekzekutive të Ministrisë së Financave, PVF-të e tyre integrohen brenda PVF-ve të MF-së. Mirëpo, për shkak se 80 % e të hyrave të BK-së mbledhen prej tyre, ato janë audituar ndaras nga PVF-të e MF-së.

- Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a
- KUR Hidroregjioni Jugor sh.a
- Stacioni i Autobusëve sh.a – Prishtinë
- KRM Uniteti sh.a
- KUR Prishtina sh.a
- Telekom i Kosovës sh.a
- Posta e Kosovës sh.a , dhe
- KRM Pastrimi sh.a, Prishtinë
- 9 projekte të financuara nga donatorët:
 - Zhvillimi rural dhe agrobujqësor (MBPZHR)
 - Ekonomia Digjitale në Kosovë (MZHE)
 - Forcimi i Planifikimit dhe Ekzekutimit në Para të Gatshme (MF)
 - Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ të Kosovës (MASHT)
 - Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH)
 - Eficenca e energjisë së ripërtëritshme (MZHE)
 - Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MTI)
 - Programi Mjedisor i Kosovës, PMK 2016-2020 (MMPH-SIDA), dhe
 - Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë (ZKM-SIDA)

13 auditime të performancës (për fusha të ndryshme, TI, prokurim, projekte)

- Sistemi i licencimit të gurëthyesve dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari
- Teknologjia Informative në Agjencinë e Statistikave të Kosovës
- ATK-Sigtas Moduli i arkëtimit të borxheve
- Auditim përcjellës për programin e trajtimit të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike (brenda dhe jashtë vendit), si dhe arritja e rezultateve përmes këtij programi
- Ndërlidhja e aftësimin profesional me tregun e punës
- Efekti i politikave qeveritare për tërheqjen e Investimeve të huaja direkte
- Vlera për para në prokurimet e centralizuara – pjesa e dytë
- Vlera për para në ndërtimin e rrugëve rajonale dhe lokale
- Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës për vitin 2017
- Monitorimi i investimeve në fushën e Teknologjisë Informative
- Zbatimi i rekomandimeve të raportit 'Fondi Zhvillimor' dhe efektet e fondit dhe
- Dy tema do të vendosen, sipas prioriteteve

Shtojca 2: Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2019

Pasqyrat Financiare dhe raporti i pavarur i auditorit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Auditorin e Përgjithshëm

Opinionin ynë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Organizata" ose "ZKA"), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019 dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar në bazë të Bazës së Parasë së Gatshme të Kontabilitetit.

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve dhe kërkesave janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit për auditimin e të pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur për organizatën në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve' Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (kodit IESBA) së bashku me kërkesat etike të / L-032 Ligjit Nr 6 (për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim), të cilat janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për të vazhduar në vijimësi, shpalosjen, sipas rastit, çështjet që lidhen me vazhdimin në vijimësi dhe duke përdorur bazën kontabilitetit për vazhdimin në vijimësi, përveç nëse Menaxhmenti ose synon të likuidojë organizatën ose të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste, përpos për ta bërë këtë. Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel të lartë të sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale kur ajo ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejm procedurat e auditimit në përgj gje ndaj këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një pasaktësie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se për një pasaktësi që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje e kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrolleve të brendshme relevante për auditimin me qëllim hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Menaxhmenti të bazës së kontabilitetit për të vazhduar në vijimësi dhe në bazë të dëshmive të marra të auditimit, dhe nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar për të tërhequr vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj shpalosjeve të lidhura në pasqyrat financiare ose, nëse shpalosjet e tilla janë të pamjaftueshme, për të modifikuar opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në prova të auditimit të marra të deri në datën e Raportit të Auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të ndërpres së qeni sipas bazës së vazhdimin në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në një mënyrë që arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me të ngarkuarit me qeverisje në lidhje me, mes çështjeve të tjera, shtrirjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Në gjithashtu sigurojmë të ngarkuarit me qeverisje me një deklaratë që jemi në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe për të komunikuar me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështje të tjera që me arsye mund të mendohet të bien në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masa mbrojtëse të lidhura.

Nga çështjet e komunikuar me të ngarkuarit me qeverisje, kemi përcaktuar ato çështje që janë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Ne përshkruajmë këto çështje në raportin e auditorit përveç kur ligji apo rregullorja e pengon zbulimin publik në lidhje me këtë çështje, ose kur, në rrethana shumë të rralla, përcaktojmë që një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat negative e të bërit këtë në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të peshoj më shumë përfitimet e interesit publik nga komunikimi i tillë.

Raport tjetër mbi kërkesat rregullatore të autoritetit mbikqyrës, Kuvendi të Republikës së Kosovës për përputhshmërinë ligjore të ZKA.

Në bazë të kërkesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne kemi rishikuar aspektin e përputhshmërisë ligjore të ZKA-së. Nga rishikimi i kryer nuk kemi identifikuar ndonjë mospërputhje me ligjet që rregullojnë funksionimin e ZKA.



Nexia KS Sh.P.K.

Rr: Xhevdet Doda,
Hyrja B, Kati 14, B1, Prishtinë, Kosovë

30 mars 2020

Neni 12

DEKLARATË PËR PREZANTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: z. AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit
Nga: z. IMRI SEMETISHTI, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)
z. ADEM SULEJMANI, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 dhe është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:


- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2019.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Datë: 21/02/2020


ZKA

Datë: 21/02/2020


ZKF

Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 13. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

		2019	2018	2017
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK	BKK	BKK
Shënime		€ '000	€ '000	€ '000
BURIMET E FONDEVE-PRANIMET				
			-	-
	Granti qeveritar	2,753	2,696	2,273
	Te hyrat vetanake	20	-	-
	Te hyrat nga AKP	122	-	-
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	95	19	54
7	Tjera/Donacion	-	3	-
8				
	Gjithsej	2,990	2,718	2,327
SHFRYTEZIMI I FONDEVE-PAGESAT				
Operacionet				
	Pagat dhe mëditjet	2,125	2,003	1,757
2	Mallrat dhe shërbimet	710	631	530
3	Shërbimet komunale	33	30	28
4				
	Gjithsej	2,868	2,664	2,315
	Shpenzimet kapitale	122	51	12
5	Tjera/Donacion	-	3	-
6				
	Gjithsej	2,990	2,718	2,327

Shënim: Pagesat nga palet e treta prezentohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 Janari 2019. Shumat janë të rrumbullakesuara në mijë Euro.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 14. Raporti i ekzekutimi të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

		2019				2018	2017
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	E
Shënime		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrja e parashë të gatshme							
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	114	114	-	-	-	46
7	Te hyrat tjera	28	20	20	8	3	2
8							
	Gjithsej pranimet	142	134	20	8	3	48
Daljet e parashë të gatshme							
	Pagat dhe mëditjet	2,125	2,125	2,098	-	2,003	1,757
2	Mallrat dhe shërbimet	710	805	723	(95)	631	530
3	Shërbimet komunale	33	35	50	(2)	30	28
4	Shpenzimet kapitale	122	147	487	(25)	51	12
5	Tjerat/Donacione	-	-	-	-	3	-
6							
	Gjithsej pagesat	2,990	3,112	3,358	(122)	2,718	2,327

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2019

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 1 Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Zyra Kombëtare e Auditimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar Auditorin e Përgjithshëm si institucion i pavarur dhe më i larti, i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas legjislacionit në fuqi, Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së. ZKA është institucion i pavarur kushtetues me mandat për kryerjen e auditimit të jashtëm në të gjitha organizatat buxhetore dhe në subjektet tjera shtetërore.

1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese janë të prezentuara si vijon:
-13 deri të neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),
-16 deri të neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€)

1.4 Valuta raportuese

Librat dhe shënimet e ZKA-së mbahen në Euro, që është valuta ligjore në territorin e Republikës së Kosovës.

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesorë Administrativë dhe Zyrtari Kryesorë Financiar.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2019

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

